

# Investimet po hyjnë në Mokër

Si kudo edhe në Mokër po punohet për krijimin e një infrastrukture rrugore sa më të mirë, për ta sjellë sa më afër standarteve të kohës

NE BRENDESI



**Shkëlqesi,  
pi një gotë për  
shpirt të babait!**

Nga Koço PIHONI

**PËRSHPIRTJE PËR  
DR. MISTO MARKON**



**Letra të një  
emigranti/Homazh  
për Qemal Bufin**



**Naum Thanas  
Gegprifti, ideator  
dhe realizator  
energjik**



**FEHIM JASHALLARI, ME 701 VOTA, ZGJIDHET  
KRYETARI I RI I KOMUNËS SË TREBINJËS**



**PËRFUNDON RIKONSTRUKSIONI I  
SHKOLLËS SË MESME TË VELÇANIT**

**K**a përfunduar rikonstruksioni shkollës së mesme të Velçanit. Në prag të festave të nëntorit, më 24 nëntor, është bërë edhe inaugurimi i ambienteve të reja të shkollës. Rikonstruksioni është bërë i mundur nga një fond i Ambasadës Gjermane në Tiranë dhe të vetë komunës së Velçanit. Rikonstruksioni total i shkollës, në të cilën mësojnë 350 nxënës në të tre nivelet, parashkollor, 9-vjeçare dhe të mesëm, me 16 mësues, përfshin rrethimin, shtimin me pllaka, rregullomini e banjave dhe ambienteve të tjera. Rikonstruksioni është kryer në bashkëpunim me shoqatën "Nehemia", e cila vepron prej ko-

hësh në këtë komunë. Për kryetarin ek komunës së Velçanit z. Ilia Mani, "ky investim është mjaft i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Ai vjen pas investimeve që kemi bërë vitin e kaluar për shkollën e Lakteshit dhe disa investime të tjera në komunë. Gjej rastin të falenderoj ambasadën Gjermane dhe shoqatën "Nehemia", të cilët bënë të mundur këtë rikonstruksion. Dua të garantoj edhe banorët e komunës se investime të tjera do të kemi, si p.sh së shpejti ujësjellësi që do të përshkojë dhe do të zgjidhë një heër e mirë problemin e ujit për pesë fshatara: Losnik, Velçan, Laktesh, Bishnicë, Slabinjë."

**Berisha: Së bashku do të ndërtojmë Mokrën turistike!**

*"...Garantoj zgjedhësit e Mokrës se autostrada Qafë Pllaçë-Qukës, do të vazhdojë pa ndërprerje, i garantoj ata se së bashku do të ndërtojmë Mokrën turistike. Ju nuk e njihni se çfarë thesaresh turistike mbart Mokra në gjirin e saj. Ato presin urbanizimin e zonës për tu bërë nga vendet më të preferuara turistike të Shqipërisë. Mokra, duhet ta mbani mend gjithmonë së bashku me Dukagjinin janë konservatet gjenike të kombit në histori..."*



**Dita e fundit e  
dy të dënuarve  
me vdekje**

Nga Bedri BLOSHMI

**LLËNGA NË RRJEDHËN  
E HISTORISË**

**OHRI-QYTET QË I BËRI  
PËRSHTYPJE TE  
MADHE**

**KONSULLIT JOHAN  
GEORG VON HAHN**

Nga Zenun FERRO

**Vallja e kapedan  
Fordinës**

Tregim

nga Istref HAXHILLARI

ZGJEDHJET NË TREBINJË, KANDIDATI I MAZHORANCËS FITOI ME 71 VOTA PARA

# Fehim Jashallari, me 701 vota, zgjidhet kryetari i ri i komunës së Trebinjës

Berisha: „Le të përshëndesim shumë përzemërsisht zgjedhësit e Mokrës, të cilët në një votim të shkëlqyer votëbesuan mazhorancën, koalicionin“

Shpallet rezultati zyrtar i zgjedhjeve të para kohshme në Komunën e Trebinjës. Kandidati i koalicionit PD-LSI, Feim Jashallari, mori 701 vota, ndërsa kandidati i PS-së fitoi vetëm 630 vota. Në këtë mënyrë, koalicioni i djathtë fitoi në këtë komunë bastion të së majtës, në Mokër, me 71 vota më shumë se kandidati i majtë. Sipas rezultatit, në proces morën pjesë 1349 votues, nga 2465 votues që ka gjithsej kjo komunë me 8 fshatra, duke marrë pjesë afërsisht 55 për qind e votuesve në proces. U shpallën të pavlefshme vetëm 18 vota. Zgjedhjet e parakohshme në komunën Trebinjë u bënë me dekret të Presidentit të Republikës, Bamir Topi, pas arrestimit të kryetarit Gjergji Buzo, që u shkarkua më pas nga Kryeministri Berisha për korrupsion pasiv. Kryetari i komisionit të votimit, Nexhmi Rapçe, pohoi se “votimi ka rrjedhur normal dhe nuk ka pasur asnjë incident deri në momentin e numërimit”. Në këtë proces votimi, Partia Socialiste mori pjesë për herë të parë pas bojkotit të gjatë pas 28 qershorit. Kjo komunë është qeverisur në 4 legjislaturat e shkuara nga socialistët. Pavarësisht mungesës së vëmendjes mediatike mbi zgjedhjet në këtë komunë, në fushatë u angazhuan deputetë që u kërkuan votën kandidatëve. Pas përfundimit të procesit dhe shpalljes së rezultatit, Kryeministri Berisha përshëndeti votuesit e Mokrës.



REZULTATI I ZGJEDHJEVE TË 24 TETORIT:

|                    |                      |
|--------------------|----------------------|
| KANDIDATI I PD-LSI | 701 VOTA             |
| KANDIDATI I PS-SË  | 630 VOTA             |
| TË PAVLEFSHME      | 18 VOTA              |
| MORËN PJESE        | 55 % OSE 1349 VOTUES |
| KOMUNA KA GJITHSEJ | 2465 VOTUES          |

Luan Rama: Ofertat e PS të jenë pa kundërvënje me bazën ligjore dhe me Kushtetutën

## LSI: U konfirmua mbështetja për koalicionin qeverisës

Lëvizja Socialiste për Integrim ka përshëndetur dje zgjedhjet e zhvilluara në komunën Trebinjë në Pogradec. Një konferencë për shtyp, sekretari i Përgjithshëm në LSI, Luan Rama pasi ka falënderuar votuesit e kësaj komune për besimin që i dhanë koalicionit PD-LSI, theksoi se në komunën Trebinjë fitoi koalicioni i integrimit. “Konfirmoj zyrtarisht fitoren e Fehim Jashallarit, kandidatit të nominuar nga LSI, por që konkurroi në emër të ‘Koalicionit për Integrim’, për kryetar të komunës së Trebinjës, i cili ka mundur të fitojë dje në një garë shumë korrekte dhe përmes një procesi zgjedhor, që nuk pati asnjë kontest dhe asnjë shqetësim apo problem. Nga kjo pikëpamje, rezultati i djeshëm është një tregues domethënës i cilësisë së angazhimit dhe



pjesëmarrjes së banorëve të zonës në votim nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, zgjedhja që ata kanë bërë është dëshmia e mbështetjes dhe e përkrahjes që gëzon LSI-ja në mënyrë të veçantë, dhe i gjithë ‘Koalicioni për Integrim’ në atë zonë”, u shpreh Rama. Ndërsa e cilësoi garën për kryetar komune në këtë komunë si korrekte dhe ka falënderuar edhe kandidatit të PS-së, Behar Kastrioti, sekretari i Përgjithshëm i LSI garantoi banorët e kësaj zone për an-

gazhimin për një drejtim korrekt dhe qeverisje me efektivitet të komunës nga kryetari i ri i saj. “Natyrshisht, unë jam sot këtu që në emër LSI-së të falënderoj në mënyrë të veçantë të gjithë banorët e zonës, ata që morën pjesë në votim, pavarësisht se për kë kanë votuar dhe të shpreh gjithashtu angazhimin për një drejtim korrekt dhe qeverisje me efektivitet të komunës nga kryetari i ri i saj. Unë do të doja të falënderoja me shumë seriozitet të dy pjesëmarrësit në garë, pra edhe kandidatit që kandidoi në emër të PS-së dhe ta ftoj atë të kuptojë që pavarësisht rezultatit, ai të mos e konsiderojë vetën të humbur, sepse fituesi, pra, kryetari i ri i komunës, do të përfaqësojë me shumë seriozitet, me shumë përkushtim edhe votuesit e Partisë Socialiste”, theksoi Rama.

KRYEMINISTRI BERISHA PËRSHËNDET REZULTATIN E ZGJEDHJEVE NË TREBINJË

“Së bashku do të ndërtojmë Mokrën turistike!”

“...Garantoj zgjedhësit e Mokrës se autostrada Qafë Pllaçë-Qukës, do të vazhdojë pa ndërprerje, i garantoj ata se së bashku do të ndërtojmë Mokrën turistike. Ju nuk e njihni se çfarë thesaresh turistike mbart Mokra në gjirin e saj. Ato presin urbanizimin e zonës për tu bërë nga vendet më të preferuara turistike të Shqipërisë. Mokra, duhet ta mbani mend gjithmonë së bashku me Dukagjinin janë konservatet gjenike të kombit në histori...”



Kryeministri Berisha në fjalën e tij në mbledhjen e grupit parlamentar të Partisë Demokratike u ndal tek zgjedhjet e pjeshme lokale, që u zhvilluan të dielën në komunën e Mokrës. Kryeministri Berisha përshëndeti zgjedhësit e Mokrës, të cilët me votën e tyre votëbesuan mazhorancën dhe koalicionin duke nxjerrë fitimtarë kandidatit e përbashkët të propozuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim. Kryeministri e cilësoi fitoren në Mokër, të një rëndësie të veçantë dhe dëshmi e një besimi të madh në rritje tek Koalicioni i Integrimit. Duke ftuar kryetarin e Partisë Edi Rama që të njohë rezultatit e këtyre zgjedhjeve, kryeministri garantoi se mazhoranca, do të japë gjithmonë kontributin e saj që në Shqipëri të zhvillohen zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Më gjerësisht në fjalën e tij kryeministri Berisha u shpreh: “Le të përshëndesim shumë përzemërsisht zgjedhësit e Mokrës, të cilët në një votim të shkëlqyer votëbesuan mazhorancën, koalicionin dhe nxorën fitimtarë kandidatit e përbashkët të propozuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim. Fitorja në Mokër, është e një rëndësie të veçantë, është dëshmi e një besimi të madh në rritje tek ky koalicion, ‘Koalicioni i Integrimit’. Komuna ka qenë e qeverisur nga Partia Socialiste, por me këtë test, nisi dhe ndryshimi i madh elektoral. Ftoj zotin Edi Rama, të njo-

hë rezultatit, e garantoj se kudo do të ketë një proces të lirë dhe të ndershëm, sikundër të shfrytëzojë të gjitha prerogativat ligjore në rast se ka vërejte.

Garantoj zgjedhësit e Mokrës se autostrada Qafë Pllaçë-Qukës, do të vazhdojë pa ndërprerje, i garantoj ata se së bashku do të ndërtojmë Mokrën turistike. Ju nuk e njihni se çfarë thesaresh turistike mbart Mokra në gjirin e saj. Ato presin urbanizimin e zonës për tu bërë nga vendet më të preferuara turistike të Shqipërisë. Mokra, duhet ta mbani mend gjithmonë së bashku me Dukagjinin janë konservatet gjenike të kombit në histori.

Ndaj dhe me këtë votim kjo është një kthesë e madhe. Kjo është një kthesë, që do të bëjë që qytetarët e Mokrës të rikthehen në zonën e tyre të bukur, mahnitëse për bukuritë e saj natyrore, por edhe për burimet që ka, mbi të gjitha burimet turistike. Duhet ta pranojmë se me këtë votë, votuan për të ardhmen, por votuan në mënyrë absolute edhe kundër 20%.

Zonja dhe zotërinj deputet, 35 katëshi, monumenti më i nxirë i korrupsionit në historinë e këtij vendit, maja e tij duket nga mbarë Shqipëria, nga Mokra dhe Valbona, nga Konispoli dhe Vermoshi, nga luginat dhe majat e maleve, ngado që qytetarë hedhin vështrimin drejt kryeqytetit. U del satori, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, u dalin ministritë, por për fat të keq, u del edhe shtylla e turpit, apo monumenti i 20%, 35 katëshet tek diga e liqenit që ju garantoj ju se nuk do të ndërtohet. Edhe në këtë aspekt zgjedhësit e mençur të Mokrës, meritojnë përshëndetje të veçantë, votuan kundër 20%.”

## OPINION

## Trebrinjëzimi i Trebinjës

Nga KASTRIOT ISLAMI

Zgjedhjet në komunën Trebinjë kanë nevojë të analizohen me qetësi. Së pari, ato janë të parat që PS-ja dhe opozita pranojnë të marrin pjesë pas atyre të 28 qershorit 2009, ndërkohë që në të gjithë zgjedhjet e tjera të pjeshme është refuzuar pjesëmarrja në zgjedhje, me argumentin se “po nuk u bë transparencë e zgjedhjeve të 2009-s, opozita nuk ka garanci për zgjedhje të lira e të ndershme”. Së dyti, ato janë të parat që PS-ja humb në një zonë, që e kishte fituar në 2007-n dhe 2009-n, edhe sikur PD-ja të ishte bashkë me LSI-në”. Shtrohen disa pyetje për PS-në. Së pari, a ishin të lira e të ndershme zgjedhjet në Trebinjë dhe nëse jo, atëherë cilat janë provat dhe faktet që e vërtetojnë këtë? Së dyti, përse u përmbys rezultati i 2009-s nga në favor të PS-së me 5.2 për qind të votave, ndaj (PD e LSI së bashku) në favor të (PD+LSI) me 71 vota në 2010?. Së treti, përse PS-ja humbet në këtë komunë, kur kishte fituar në 2007-n? Së katërti, përse PS-ja del në 2010-n me rezultate më të keq se në 2009-n? Ky rezultat është një arsye më shumë përse analiza për 2009-n duhet të mbështetet në dy këmbë: 1) ndikimi i parregullsisve në rezultatit zgjedhor (Trebinja nuk duket të jetë një shembull i tillë) dhe 2) çfarë (mirë/keq)funksioni në mekanizmin e PS-së e të koalicionit të saj në 2009-n? Tani, për të bërë projektionin për 2011-n duhen shtuar edhe dy elementë të rëndësishëm 1) si ka ndikuar strategjia e veprimeve të deritanishme të opozitës në rezultatit zgjedhor të 2010-s? dhe 2) sa do të ndikonte fakti që LSI-ja do të jetë në koalicion me PD-në në zgjedhjet vendore të 2011-s? Sigurisht, rasti i Trebinjës tregon se këto dy pyetje marrin përgjithësisht përgjigje negative për PS-në.

## Trebinja 2007..

Kandidati i PS+LSI-së ka fituar 49.8 për qind të votave, kurse kandidati i PD-së 48.8 për qind të votave. Pra, kandidati i majtë ka fituar rreth 1 për qind vota më shumë, duke dalë fitues më një rezultat të ngushtë. Po t'i referohemi rezultatit të partive, rezultati se PS-ja ka fituar rreth 17 për qind të votave, kurse LSI-ja rreth 16 për qind të tyre. Ndërkohë, PD-ja ka fituar rreth 11.5 për qind të votave. Dhe të gjithë pjesën tjetër të votave, rreth 55 për qind të tyre i kanë fituar partitë e tjera, duke vërtetuar tezën që në zgjedhjet vendore ka një shpërndarje të votave nga partitë e mëdha drejt partive të vogla.

## Trebinja në 2009...

Rezultatet në Trebinjë, në vitin 2009 janë PD (APN) 37.6 për qind. PS (BPN) fitoi 52.1 për qind dhe LSI (ASI) fitoi 9.3 për qind. Edhe sikur në vitin 2009, PD-ja të ishte bashkë me LSI, nuk do të arrinte më shumë sesa 46.9 për qind të votave, ndërkohë që PS kishte fituar 52.1 për qind. Kështu, opozita e drejtuar nga PS-ja në 2009-n ka fituar 5.2 për qind më shumë vota, sesa PD-ja plus LSI-në. Në vitin 2009, opozita ka një ngritje të rezultatit në Trebinjë po të krahasohet me 2007-n. Konkretisht, vetëm PS-ja merr 52.1 për qind të votave shumë më tepër se ç'kishte fituar PS-ja plus LSI-në në 2007-n (49.8 për qind të votave)

## Trebinja 2007 dhe 2009 për partitë politike...

Le t'i referohemi rezultatit të partive politike. Në zgjedhjet 2007, koalicioni i PS-së fitoi 613 vota, kurse koalicioni i LSI-së - 246 vota. Pra, gjithsej e majta fitoi 859 vota, kurse koalicioni i djathtë, i drejtuar nga PD-ja, kishte fituar 527 vota. Në 2009, koalicioni i PS-së fitoi 730 vota, koalicioni i LSI-së 130 vota, ndërsa e majta gjithsej 860 vota, saktësisht sa në vitin 2007. Kurse për “çudi” koalicioni i djathtë, i fituar nga PD-ja, fitoi 527 vota po aq sa në vitin 2007. Çfarë del nga ky krahasim? Së pari, votuesit e majtë e të djathtë kanë votuar në mënyrë saktësisht të njëjtë në 2007 dhe 2009, pra diferenca e majtë, minus e djathtë, nuk ka ndryshuar. Së dyti, në 2009 PS-ja është rritur në kurriz të LSI-së, e cila ka humbur rreth 116 vota. Pra, ka ndodhur vetëm një rialokim brenda të majtës, pa kaluar asnjë votë nga e majta në të djathtë apo anasjelltas...

## Trebinja 2010...

Kandidati i PS-së merr 71 vota më pak sesa kandidati i koalicionit qeveritar PD+LSI. Ndërkohë që po t'u referoheshim rezultateve të 2009, kandidati i PS-së duhet të kishte 5.2 për qind më shumë sesa kandidati i koalicionit qeveritar. Përfundimi është i qartë: Kandidati i PS-së ka realizuar një rezultat më të keq jo vetëm krahasuar me 2007, por krahasuar edhe me 2009. Dhe rezultati është aq më i keq, sa që rezultati i 2007 dhe 2009 në favor të PS-së përmbysset në favor të PD-së, plus LSI.

## Në vend të përfundimit...

Zgjedhjet në Trebinjë janë një test në një komunë me rreth 1500 votues, për të nxjerrë përfundime për zgjedhjet e ardhshme vendore. Dhe për më tepër, një test në një komunë të fituar nga PS-ja edhe në 2007 edhe në 2009 dhe të humbur në 2010, pra të fituar nga koalicioni qeveritar. Pra, jo një test në një zonë të fituar nga PD-ja apo koalicioni qeveritar PD+LSI, apo në një njësi vendore të diskutueshme. Pa u nxituar duhen parë edhe efektet e faktorëve të tjerë, si për shembull 1) si u zgjedh kandidati i opozitës krahasuar edhe me atë koalicionit qeveritar, 2) si e zhvilloi fushatën opozita në krahasim me koalicionin qeveritar, 3) si dhe sa ndikoi fakti që në mes të mandatit, ish-kryetari i majtë i komunës u shkarkua. Natyrisht, për të qenë realist në këtë analizë duhet pranuar se në zgjedhjet e pjeshme, aq më tepër në një komunë të vogël, kandidati i koalicionit qeveritar është gjithnjë më i favorizuar. Sidoqoftë, minimalisht në planin psikologjik e politik, ky është një rezultat negativ për opozitën dhe duhet analizuar me seriozitet. Aq më tepër duhet pasur parasysh se 1) “konstantja gati - gati “historike”: e majtë minus e djathtë” ruhet pothuajse kudo, 2) se LSI-ja do të jetë në koalicion me PD-në dhe kjo lëvizje nga e majta në të djathtë ka efekt dyfish në vota në favor të koalicionit qeveritar dhe 3) në zgjedhjet vendore gjithnjë ka një shpërndarje nga partitë e mëdha drejt partive të vogla.

# Jashallari: Prioritet imediat rikonstruksioni i shkollave dhe projektbuxheti 2011

Feim Jashallari, kandi dati i Lëvizjes Socialiste për Integrim, i cili fitoi dje zgjedhjet për të kryesuar komunën e Trebinjës në rrethin e Pogradecit th në një prononcim për mediat se rezultati i zgjedhjeve dëshmon se koalicioni i integrit PD-LSI është tërësisht funksional. Kryetari i ri i Komunës së Trebinjës, Jaçallari tha se fitorja e tij u realizua në një zonë bastion të Partisë Socialiste, që dëshmon më së miri “Aleanca për Integrim” ka punuar në drejtimin e duhur.

“Zgjedhjet ishin korrekte dhe të standardeve evropiane”, u shpreh Jashallari, ndërkohë që shpreh falenderimet e tij për kandidatin e PS-së, Kastrioti për mënyrën se si zhvillua gara dhe mirëkuptimin e besimin e treguar nga zgjedhësit.

Edhe pse është zgjedhur kryetari i komunës së Trebinjës për një kohë relativisht të shkurtër, Feim Jaçallari thotë se prioritet i punës së tij do të jetë zgjidhja e disa problemeve më emergjente të zonës.

Jashallari bëri me dije se ka hartuar një program afatshkurtër

**“Në ditën e parë që do të futem në zyrë do të jap urdhër për rregullimin e gjendjes së rëndë të disa shkollave, në mënyrë të veçantë të çatave të tyre, ku shiu që bie jashtë hyn brenda. Në disa raste gjatë fushatës elektorale fëmijët na ndalonin në rrugë dhe na kërkonin rregullimin e shkollave. Do të mundohem që brenda këtij muaji të zgjidh probleme emergjente, në mënyrë të veçantë rikonstruksionin e çatave të shkollave dhe kopshteve, pajisjen me xhama të të gjitha dritareve, furnizimin me dru, etj”, nënvizoi kreu i ri i komunës së Trebinjës.**

dhe afatgjatë, në vëmendjen e të cilit do të jenë shkollat dhe kopshtet e komunës së Trebinjës, ku kushtet e zhvillimit të programit mësimor janë të vështira.

“Në ditën e parë që do të futem në zyrë do të jap urdhër për rregullimin e gjendjes së rëndë të disa shkollave, në mënyrë të veçantë të çatave të tyre, ku shiu që bie jashtë hyn brenda. Në disa raste gjatë fushatës elektorale fëmijët na ndalonin në rrugë dhe na kërkonin rregullimin e shkollave. Do të mundohem që brenda këtij muaji të zgjidh probleme emergjente, në mënyrë të veçantë rikonstruksionin e çatave të sh-

kollave dhe kopshteve, pajisjen me xhama të të gjitha dritareve, furnizimin me dru, etj”, nënvizoi kreu i ri i komunës së Trebinjës. Ai theksoi se ka mbështetjen e duhur nga qeverisja për të realizuar programin e tij.

Një ndër prioritetet e punës së kryetarit të sapozgjedhur të komunës së Trebinjës do të jetë dhe hartimi dhe miratimi i projektbuxhetit të vitit 2011.

Në këtë drejtim, Jashallari, tha se do të bëhet një hap i madh përpara pasi do të krijohet mundësia që komuniteti i komunës së Trebinjës të marrë pjesë në këtë proces.

## INVESTIMET PO HYJNË NË MOKËR

Nga Zabit CUKU

Si kudo edhe në krahinën e Mokrës po punohet për krijimin e një infrastrukture rrugore sa më mire, për ta sjellë sa më afër standardeve të kohës. Kështu riparimi dhe ndertimi i rrugëve në drejtim të Mokrës ka filluar të zhvillohet më tej.

\* Segmenti që lidh rrugën nacionale Urakë-Golik, po rikonstruktohet, në një gjatësi prej 8 kilometrash duke bërë zgjerimin e saj deri në 6 metra dhe me dy kalime. Deri në javën e tretë të muajt tetor ishte asfaltuar 3 kilometra, vazhdon puna për përfundimin e saj sipas projektit dhe planit.

Ndërtimi i saj po realizohet nga një firmë nga Mati.

\* Segmenti Qukës-Golik, i cili është pjesë e segmentit rrugës Qukës-Qafë-Ploçë, një rrugë strategjike për Shqipërinë, po dhe për permissimin e jetesës së komunitetit në krahinën e Mokrës. Për ndërtimin e saj punon firma ndërtuese “Salillari,, me kapacitetet e saj. Rruga është zgjeruar sipas standardeve të një autostratade. Rruga do të shkojë afër kalasë Manastirecit nga poshtë. Do të bëhet një urë e gjatë rreth 300 metra. Në vazhdim janë në proces për të filluar edhe lotët e tjerë në drejtimin e Mokrës.

\* Ujësjellësi Bishnicë-Slabinjë.

Ky ujësjellës është ndërtuar në vitet 1980, me një tubacion 200 mm. Por kërkesat janë në rritje dhe për një tubacion të përmasaave më të mëdha, për arsye se këtë sasi e përballon edhe vetë burimi ujit që është aktualisht. Për këtë është dhënë investimi dhe ka filluar rikonstruksionin, duke e ndërtuar me dimensione më të mëdha, ku me këtë prurje uji do të plotësojë të gjitha nevojat e fshtarave, Velçan, Losnik, e Slabinjë puna ka filluar në gusht të vitit 2010 dhe sa më shpejt uji do të jetë plotësisht në çezmat e këtyre banorëve të cilët e kanë prituri prej kohësh.

## EMIGRIMI DHE MIGRIMI KA ULUR NUMRIN E NXËNËSVE NË SHKOLLËN E SLABINJËS

Nga Fuat FERRO

Në shkollën 9 vjeçare të Slabinjës, sistemi 9-vjeçar filloj në vitin mësimor 2008-2009, me 12 nxënës. Pas përfundimit të vitit 10 nxënës prej tyre, vazhduan shkollën e mesme të përgjithshme në Propriisht. Drejtimin e shkollës 9-vjeçare në Slabinjë në vitin 2005, e mori Marieta Sinani, e cila e drejtoi deri në vitin 2009, në këtë vit u emërua Xhevat Balliu.

Ndihma për nxënësit në Propriisht, nga Komuna është bërë, ka një mikrobus, me një biletë simbolike 30 lek vajtje-ardhje. Shkolla në vitin 2010 ka 94 nxënës që vazhdojnë shkollën, por e ardhmja do të jetë jo e mirë. Emigrimi dhe migrimi i fëmijëve të saj ka rënë, që në vitin 2010, në klasën e parë do të jenë 5 nxënës, në vitin 2011 shkon në 10 vetë. Brezi i ri është larguar, dhe kjo do të sjellë ulje gradualisht të fëmijëve në shkollë.

Stafi i mësuesëve është me eksperiencë dhe punojnë me përkushtim, si Marieta Sinani, Jonus Roka, Mirela Bufi, Ani Kopia, Entela Oldashi, Belfina Topalli, Daliko Balliu.

Edhe në shkollën e Slabinjës, po vazhdon bashkimi klasave të parë-tretë, dhe e dytë-katërt për shkak të nxënësve, që janë pak. Në vitin 2010-2011 në klasën e 9-të vazhdojnë mësimet me 16 vetë.

Kam mbi 30 vjet në arsim, shkollën e re e kemi ngritur me përkushtim të madh. Edhe shelgjet zbukurues e dekorativ i kam marrë e mbjellë nga Elbasani, isha me motor kur kam bërë këtë veprim.



## Dita e fundit e dy të dënuarve me vdekje

Nga Bedri BLOSHMI

**N**atë pritje. Dhimbje, tmerr, ënrra, frikë, heshtje. Të gjitha këto i mbulonte ajo që dëshironim, shpresa. Po kush do të vijë vallë në këtë pritje pa fund? Jeta apo vdekja?

Qetësi. Çdo gjë fle. Të gjallët, të vdekurit, varret, xhelatët dhe ata që presin të vdesin "fletë", presin e presin.

Ja një dridhje zhurme. Hapet dera e hekurit që të sjell në korridorin e birucave. Përsëri qetësi. Kush erdhi vallë? Jeta apo vdekja? Në vend të jetës paska ardhur vdekja me hapa të lehtë. Më në fund dëgjohej një zë:

- Po ti këtu kush je? Mos u tremb. S'kam ardhur për ty, por për këtë tjetër. Zgjoje! Të vdesësh është më mirë se sa të rrosh! - Zëri pyet përsëri: - Kush je? Çfarë do këtu?

- Unë jam Rustemi - u përgjigj tjetri, - më kanë sjellë të ndihmoj Vilsonin. Ta kthej në krahuin tjetër, t'i fërkoj duart e shpatullat sepse shpesh i mpihen nga hekurat, ta ushqej, t'i fshij dhe djersët se siç e shihni është shumë nxehtë. Sot u bënë 35 ditë që ai është i lidhur duar e këmbë dhe në kokë i kanë ngjeshur një helm. Vetëm ia lidhin e çoj në banjë ia zgjidhin këmbët, duart ia lidhin përpara me litar cepin e të cilit e mban polici. Pasi mbaron punë ia lidhin ato sërish pas shpine. Po ti kush je? - pyet Rustemi. - Po bisedojmë, por unë as të shoh dhe as po të njoh?! Nga hyre? Dera është e mbyllur.

- Nuk po e kupton se kush jam dhe përse kam ardhur? - iu përgjigj zëri. - Ja për atë aty kam ardhur. Sonte do ta marr! Kam një urdhër me shkrim që thotë se ai nuk duhet të jetë më pas orës 24<sup>00</sup>.

Rustemi vazhdon të qëndrojë i mbështetur me shpinë pas murit pa i kthyer përgjigje zërit dhe shikon nga Vilsoni i cili rri shtirë me kuriz e nuk dihet nëse e dëgjo bisedën e tyre.

Zëri urdhëroi: - Zgjoje! Si mundet ai të fletë?

- Jo ai nuk po fle, nuk mund të lëvizë se është mpirë, - u përgjigj Rustemi. - Mëkat, është shumë i ri. Një muaj pasi e arrestuan u bë me vajzë të cilën s'e ka parë asnjëherë. Nuk mundem ta zgjoj. Foli vetë. Tek biruca tjetër ndodhet vëllai i tij të cilin e dënuan me 25 vjet burg. Sa keq! Vajza do të rritet jetime dhe gruaja do t'i mbetet rrugëve.

- Mos m'i thuaj mua këto. I di të gjitha. - iu hakërrua zëri. - Zgjoje se kam edhe të tjerë për të marrë!

- Kë do marrësh tjetër, Gencin? - e pyet Rustemi.

- Jo, more jo. Gencin e mora më parë. E hipa në makinë dhe pret me duar të lidhura pas shpine atje. Rreth tij janë disa oficerë që po e ruajnë sa të kthehem unë. - ulëri zëri.

- Edhe Genci ka dy fëmijë, Petrikën dhe Eglantinën. - i thotë Rustemi.

- Ti kujton se unë nuk kam biseduar me Gencin? - ia pret po me të njëjtën egërsi zëri. - Të dyve bashkë do t'ua marr shpirtin, mos ki merak se nuk i ndaj! Siç diskutonin bashkë për muzikën, letërsinë dhe poezinë, po ashtu edhe shpirtin bashkë do t'ua marr!

- Rustem, me kë po flet? - pyet Vilsoni. - Më kthe nga ana tjetër të lutem se jam mpirë krejt.

- Vilson, mos i harxho çastet e tua të fundit me këto kërkese. Në vend që të kërkosh të ndërrosh pozicion duhet të çohesh e të vish me mua për të shkruar tek vendi i caktuar. - iu hakërrua zëri të dënuarit.

- Ti? Paske ardhur? - përgjigjet Vilson. - Gati jam, por si të të ndjek kur i kam këmbët ende të lidhura? Nëse kam ende pak kohë, më plotëso një dëshirë të fundit.

- Dëshirën e fundit do ta thuash përpara grupës, - ia kthen zëri.

- Kërkesa ime është e veçantë, jo si ato që je mësuar të dëgjosh ti para se t'u marrësh shpirtin njerëzve. - ia kthen Vilsoni.

- Ç'kërkesë thua more? A e di ti se ku do të të çoj? Unë jam vdekja! - përgjigjet zëri.

- Po, po e di. E kuptova. E dëgjova të gjithë bisedën që bëre me mikun tim Rustem. - thotë Vilsoni.

- Atëherë, cila është kërkesa jote? Ma thuaj. - ia pat vdekja.

- Dua të më lejosh të shoh për herë të parë dhe të fundit vajzën time, - thotë Vilsoni. - Të lutem, ma bëj këtë nder.

- Unë di vetëm të marr shpirtin, nuk di të bëj nder të tjera veç këtij. Ja dhe urdhëri i ministrit të brendshëm, Kadri Azbiu, që më lejon ta bëj këtë. Në të është shkruar ora, data dhe vendi ku unë do të kryej "nderin e fundit".

- Dera u hap dhe në birucë u futën policët. - Zgjidhja këmbët, lidhja duart përpara dhe nxitoni se u vonuam! - udhëroi vdekja.

Policët e kapën Vilsonin nga krahët dhe e ngritën në këmbë. Kur ishte në prag të derës Vilsoni kthehet dhe i thotë Rustemit:

- Dua të të le një amanet. Kur të lirohesh nga burgju, shko te familja ime dhe thuaju se unë nuk i kam turpëruar. Akuzën nuk e pranova sepse nuk kam bërë asgjë të tillë aq më tepër ndonjë faj. Rustem ma bëj halla shërbimin që më për 35 ditë. Lamtumirë!

### URDHEROJ

Te denuarit Geno Bardho (Fein) Leko dhe Vilson Sani Blloshmi te ekzekutohen me vdekje (pushkatim), në vendin e caktuar me datën 14-11-1977 ora 24.00.

Per ekzekutimin e tyre ngarkoj Degen e Punove te Brendshme Librashd.

Para se te ekzekutohen te njeftohen te denuarit se kerkesat e tyre per faljen e jetes jane refuzuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Mbas ekzekutimit i ngarkuari ne kete pune duhet te boje procesverbalin e ekzekutimit te vendimit qe mban dhe fjalën e fundit te te ekzekutuarve, i cili i dergohet Drejtorise se Hetuesise.

Faksimile e vendimit të Ministrisë së Brendshme për ekzekutimin e Genc Lekës dhe Vilson Blloshmit

MINISTRI I TËRHEMËS



## Përschpirtje për Dr. Misto Markon

Nga Tomi Mato

**N**ë respekt e dashuri për Doktorin e shquar dhe dramaturgun e talentuar Misto Marko (Mirosh Markaj) Bashkia e Pogradecit, më datën 22 tetor dhe motra e tij Irini Shuke, shokët e miqtë e tij dhe kisha "Fjetja e Shën Mërisë", në datën 23 tetor me rastin e 40 ditëve të shuarjes të tij larg vendlindjes në Amerikë organizuan dy përschpirtje për kontributin që doktori dhe dramaturgu la prapa. Në ambientet e kishës "Fjetja e Shën Mërisë" brenda dhe jashtë (ku doktori ishte pagëzuar vënë kurorën e martesës dhe (kishite kontribuar për ringjalljen e fesë në erën e demokracisë) u mblodhën familjarët shokët, miqtë dhe qytetarë për t'i shprehur ngushëllimet dhe mirënjohje të motrës së tij Irini Shukes.

Për jetën dhe veprën e tij foli bashkëqytetari dhe miku i tij Tomi Mato. Ai para se ti bënte një rezumë veprimtarisë të Misto Markos recitoi vjershën që dajua i tij shkrintari i shquar "Nderi i Kombit" Mitrush Kuteli kishte shkruar në vitin 1941 në tetor në fshatin Stepanofkë - Ukarinë vjershën "Po të vdes në dhe të huaj"

Po të vdes në dhe të huaj

Shortë Mëagimtari

Të m'a bëni varrin tim

Ku do bje së pari

Pa një grusht nga toka jonë

Baltë nga balta e vete

Të ma sillni e t'avini

Drejt në zemër shketë

Se kjo balt e vendit tonë

Mallet do m'i shuaj

S'do më duket fort i rëndë

Moj ky dhe i huaj

Daja paska aluduar që këtë perlë t'ia kush-tonte nipit të tij. Midis të tjerave miku i tij tregoi fakte që doktori Misto Marko që nga viti 1953 që mbaroi studimet për mjekësi e deri në vitin 1989 që doli në pension afro 40 vjet i shërbeu popullit të tij në qytet dhe fshat me përkushtim human dhe zotësi profesionale. Është vështirë u tha të gjes një shtëpi që këmba e doktorit s'ka kapërcyer pragun e ka hyrë në shtrat ku lëngonte i sëmurë. E merita e tij është se të gjithëve ju hiqte dhimbjet dhe shtonte jetën. Ky shërbeu që doktori i bëri popullit i detyroi qytetarët dhe fshatarët të pikëllohen ndezin qirin në ambientet e kishës dhe ngushëllojnë bashkëshorten dhe fëmijët për humbjen e njeriut të tyre të shtrenjtë - Amerikë.

Për gjurmët që la prapa duke shërbyer me ndërgjegje të lartë folën deputeti i Partisë Demokratike Përparim Kadilli, kryetari i Bashkisë z. Artan Shkëmbi, kryetari i Partisë Demokratike të qytetit Zoti Niko Dudo, Piktori mirënjohur Anastas Kostandini, kolegu i tij i punës dr. Qirici, miku i tij Vaso Samsuri, infermieri që kish punuar me dr Miston, Mihallaq Busho etj. Të gjithë me respekt e dashuri folën për punën e tij.

Të nesërmen më 23 tetor brenda dhe jashtë ambienteve të Kishës "Fjetja e Shën Mërisë" motra e tij Irini Shuke shokët dhe miqtë e tij dhe shërbëtorët e "Shtëpisë së Zotit" "At Vasil Vasil mbi bazën e riteve të fesë ortodokse kujtuan dhe vlerësuan kontributin e tij si fetar dhe kontributin që dha ai në epokën e demokracisë në shoqatën "Feja dhe Kombësia". At Vasil mbasi përfundoi liturgjinë fetare në bazë të zakonit e morën fjalën përsëri miqtë e doktorit. Kjo ceremoni mortore brenda kishës e shoqëruar nga meloditë fetare të ekzekutuara nga korri Kishës dhe jehona e kabanës që binte herë mbas here dhe qirinjtë e ndezur brenda kishës ingashëreu gjithë të pranishmit. Në fund të ceremonisë të pranishmit puthën me radhë fotografimin e doktorit. Jashtë familja e së motrës përshpirt të Dr mitos ju serviri të pranishmëve gote raki kafë grurë dhe gurabije. Edhe në këtë përschpirtje mori pjesë deputeti Përparim Kadilli, Niko duhua, autoritetin e vendit dhe vajzat e Mitrush Kutelit i Politiketeni dhe Atalanta Pasko.

Gjithë kjo veprimtari u zhvillua për ta kujtuar Doktor Miston më 22 dhe 23 tetor u fiksua nga kamera e televizionit "Sot 7" dhe në mbrëmje dhe të nesërmen u transmetua në ekran të televizionit.



Lasgush Poradeci dhe Dr. Misto

Është e nevojshme të kujtojmë se gjithë qytetarët dhe fshatarët që ishin prezent dhe ata që nuk kishën vend për të hyrë në ambientet e kishës kujtuan dhe vlerësuan kontributin e Doktor Mistos. Ai siç e theksuan të pranishmit ka meritën se emancipoi qytetin e fshatit jo vetëm në drejtim të përmirësimit e shërbimit shëndetësor por edhe të kulturës qytetare. Imponoi me veprimtarinë letrare lexuesve të shumtë ushqim shpirtëror.. Kudo nëpër reportazhet, tregimet, romanet e veçanërisht dramet e shumta që ju çmuan me vlerësime të larta (Si trilogjia Gjergj Kastrioti) me çmim të parë në konkurs apo opera "Zgjimi" me çmim të tretë e të tjera pasuruan kulturën tonë kombëtare.

Referuesit ranë në emërs të përbashkët se doktori Misto Merko gjatë jetës së tij pati fat që pati një bashkudhëtarë të mençur fisnike, bujare, singertë edhe frymëzuese si Zonja e madhe e qytetit, bija e Agllës dhe gazetarit dhe intelektualit Koco Seminit. Astrita për dr. Miston ishte shoqe e ngushtë, edukatore, qytetare dhe shtëpiake shembullore. E linte Miston të punonte ditë e natë dhe rriti dhe edukoi dy djem dhe çuan qytetarë të nderuar. Sjellja e Astritas është veprimtari se si gruaja dhe burri jetojnë në harmoni e mirëkuptim njerëzor.

Për mjekun që Këshilli Bashkiak e nderoi me titullin "Krenari e qytetit" fjalë ngushëllimi dërguan edhe miqtë e tij të shumtë nga Diaspora. Shkrintari dhe akademiku njohur Zoti Nuhi Vinca në emër të miqve dhe shokëve të tij i dërgoi ngushëllimet më të përzemërta familjes (motrës) së tij Irinit dhe u lut ti jepja numrin e telefonit për ta ngushëlluar të shoqen Astritën në Amerikë. Edhe miku i tij nga Tirana inxh. Thoma Afezollit etj u hidhëruan për humbjen e doktor Mistos.

Dr. Misto Markua mësoi në karakterin e tij cilësitë e një qytetari që i shërbeu popullit të tij shoqërisë civile me përkushtim e ndërgjegje të lartë. Ai si daja Mitrush Kuteli ishte demokrat. Nismëtar i ideve të shenjta demokratike ai i shfaqti si në qytet e fshat. Luftoi deri sa i regëtiu damari për epokën e ndritur të Demokracisë. Ishte veprimtar i shquar shoqëror, sekretar i "Shoqatës miqtë e Lasgushit dhe Mitrushit", kryetari i shoqatave "Feja dhe Kombësia dhe "Nënë Tereza". I gjendur në çdo veprimtari shoqërore. Me fjalën e tij të mençur emanciponte mendimin demokratik shoqëror.

Duke çmuar kontributin e tij si mjek, shkrintar dhe veprimtar demokrat deputeti Përparim Kadilli propozoi që spitalit të qytetit ti vihet emri Misto Marko. Këtë ide e mbështeti Kryetari i Bashkisë Zoti Artan Shkëmbi.

Kjo veprimtari që u zhvillua në kujtim të Misto Markos në kishë siç u hap me vjershën "Po të vdes në dhe të huaj" të dajës së tij Mitrushit e madh u mbyll po me tregimin e bukur po të Kutelit "Qysh e gjeti rrugën e zotit Ago Jakupi". Dajua prapë në gojën e Ago Jakupit thotë "Në kohët e fundit nisën e u rralluan fort pleqtë e fshatit si të velur nga kjo botë njëri ndërroi jetë buzë vjeshte, ashtu sic ndërroi jetën "plaku" zoti qytetit tonë doktor Misto Markua. Tani e tutje për tu çmallur do takojmë vetëm në ëndërr ndaj do ti lutemi perëndeshës së ëndrrave Orenusit të na e fanepsë sa më shpejt. Në këtë ceremoni në emër të qytetarëve të Pogradecit ju lutën Zotit t'ia dërgojnë dashurinë, respektin mirënjohjen në formë buqete e t'ia vendosi mbi zemrën e tij atje në Amerikë se shpirtin e tij e morën engjëjt e shpunë në parajsë më 16 shtator 1010.

**D**omosdova ngjan si toponim jo vendas. Në fakt, legjenda e bën shumë shqiptare. Dhe, me zakonisht kombëtar për t'i thjeshtuar gjërat dhe për t'i sjellë direkt në kohën tonë dhe ajo e ka një burim. Noli shkoi më tej dhe në përkthimin e tij të 'Don Kishotit', diku do të përdorte si term Universiteti i Domosdovës (!), një sagesë që duket se e tejkalonte dhe vetë hiperbolën e famshme të Servantesit me 'Donin' e tij të vetmuar. Por sa të rrosht do të mësohet. Dhe, shqiptarët që e lexonin fisnikun e fshatit të vjetër spanjoll mundoheshin të ngjallnin sa duhet përfytyrime duke e krahasuar me Rrogzhinën dhe Domosdovën. Po legjenda e vendit është edhe më e thjeshtë. Quhej dikur Torvioll dhe Skënderbeu u tha luftëtarëve të tij para betejës së vështirë se kjo betejë duhej fituar me doemos...Dhe mbeti kështu.

### Fëmijët

Kështu kujtohem kur ngjitemi në Qafën e Thanës, gati pas një udhëtimi prej dy orësh e gjysmë nga Tirana. Kaq zgjat të paktën vetëm nëse shoferi ia vlen. Në pak minuta, që kalojmë maloren e këndshme të Qafë Thanës, gjejmë kohën për të qëndruar. Makina, çuditërisht, në me-trat e fundit s'mbushet më me gaz.

...S'ka asgjë veç një rrugë të mirë urbane dhe ...Ah, po edhe lavazheve. Kudo janë këto lajtoje të makinave, në pritë të atyre që kalojnë aty pari. Qafë Thana është e mbipopulluar me lavazhe. Djemtë e rinj, që shërbejnë (shumë syresh shumë larg moshës së punës) hedhin ujin si shatërvan dhe i kënaqen mjedisit. Të gjithë të grishin me duar sipër dhe me lloj-lloj veprimesh groteske. Pak më lart, të gjithë shesin, por gati të njëjtën gjë. Çuditërisht gati prodhimet që i kemi në qytet dhe me atë çmim. Është e vështirë në Shqipëri që të dalosh në prodhimin e fshatarit shqiptar nëse është vërtetë i tij apo thjesht e ka marrë pas dy duarsh të tjera grosistësh. Po, ani, ata shesin dhe po ia dolën dhe mund të gjejnë myshteritë. Pak qindra metra më tutje drejt majës të Qafë Thanës askush nuk do t'ia dijë. Dhe pak metra do të hapet syprina e madhe e liqenit të Ohrit, që ne me krenarinë tonë e etiketojmë thjesht: Liqeni i Pogradecit. Ndërsa shoferi qëndron...në përpjekje për të rregulluar ne shkëputemi pak për të parë Domosdovën nga sipër. Nuk e dimë se kjo pak do jetë shumë.... Makina po gulçon nga defekti.

Një specialist ushtarak, që udhëton me ne, ka gjetur kohë të na shpalosë kulturën e tij ushtarake. Është i bindur se mjafton ta shikosh nga sipër dhe mund të heqësh paralele kudo të strategjisë ushtarake. Këtë vinin karvanët. Po këtu (tregon me dorë). Ushtritë prisnin mu këtu. Ah...dhe diçka! Në varësi të kohës. Sepse ushtritë Osmane e kishin zakon, që ta fillonin luftën vetëm në pranverë. Lufta duhej të mbaronte në vjeshtë. Duket se në këto kufij kohorë, ushtarakët lokalë duhet të kenë ditur dhe të kenë manovruar. Të stërthëna, nuk kuptoj gjë se kush është strategjia, por burri s'ndalet. Dy djem të rinj, që ndiqen nga një çift i vogël fëmijësh më të vegjël, afrohen ngadalë. Janë dy lopë përtej, për të cilat duhet të kujdesen. Është një dhi e bardhë, e cila sorollatet andej-këndej dhe janë edhe dy lopë të stërmëdha. Djali është më i vogël, ndërsa vajza më e madhe. I tërheq habia, por më shumë se çfarë shpjegon 'strategu' ushtarak. Duan të bisedojnë, por duken aq se kanë frikë. Dhjetë minuta më vonë, vajza do më thotë se ka gjashtë motra, ndërsa babai i punon në Greqi. Ndryshe nuk mund të jetë. Të gjithë që të jetojnë duhet të ikin. Këtu s'ka vend!!! Ka aksentin e Pogradecit dhe është shumë e përkorrë. Djali i pavëmendshëm shkon pas dhisë të bardhë. Fëmijët mbajnë dhe bagëtinë e dy të tjerëve, që tashmë kanë ikur dhe s'duan t'ia dinë fare. Nuk kanë asgjë tjetër. Flasin me fjali fare të shkurtra dhe thjesht përgjigjen pohues ose mohues. Djali është i bindur se do të iki shpejt. Sot, nesër, apo kurdoqoftë sa të mbarojë

# Mbi Domosdovën e Skënderbeut



dhe pak vite shkollë dhe do të ikë. Djemtë nga larg na kanë thënë të njëjtën gjë. Me dy celularë të mirë japin e marrin pafund nga larg, sikur duan të na tregojnë ndryshimin. Dhe, s'begenisin të rrinë më. Ideja e shkollës ose e bisedës së tillë i lodh. Strategu e ka humbur. S'ka më audiencë. Të habitshëm fëmijët në kërkesat e tyre. Nuk mësojnë dot, sepse mësuesit janë të bezdisur ndërsa poshtë në fshat gjithmonë e më shumë kanë mbetur pak fëmijë. Ata që rrinë dhe pak të gjithë mendojnë të ikin. Greqi? Itali? Vetëm këtu jo...

### Evlija Çelebiu

Nga Elbasani u nisëm me bismi-lah drejt lindjes dhe pas katër orësh udhëtimi mbërritëm në Bjeshkët e Banjës, në të cilat Benko Pasha, në kohën kur ishte sundimtar i Rumelisë ka ndërnuar një drom të rregullt, nëpërmjet të cilit janë dërguar topat që pati nisur mbreti për në Kotor të Venedikut.

Kjo Bjeshkë mban katër orë dhe pastaj mbërritëm në katundin e Banjës.

Nga Banja ecëm dhe tetë orë po në drejtim të lindjes dhe pasi kaluam edhe një herë lumin e Elbasanit, arritëm në Domosdovë. Këtu është kufiri që ndan Elbasanin me Ohrin. Prej Domosdovës zbritëm nëpërmjet një shpati në bregun e liqenit të Ohrit dhe pas pesë orë udhëtimi u futëm në kështjellën e Strugës.

### Për Fushën dhe të tjerat

Vetëm këtu jo, më tingëllon në vesh, ndërsa nga larg -janë disa që vazhdojnë të merren me makinën. Shumë syresh e përshkojnë drejt "Fushën e Domosdovës", që u bë strehë më vonë e banorëve që erdhën pas atij gjaku masiv të derdhur aty. Emri i qytetit të Përrenjasit ka lidhje pikërisht me të njëjtën betejë, ku u derdh ai gjak dhe u vranë aq shumë luftëtarë, sa që gjaku i tyre rridhte si përrua në përfytyrimet lokale. Në fakt, nuk ka shumë referenca pastaj. Ne më shumë kemi bëma gojore se luftëra. Shqipëria u paqta, ndërsa falë pasurive minerare ky vend u bë shekuj më vonë strehë e qytetit të ri të Përrenjasit. Në Socializëm, ku mori jetë fshati, që u kthye pastaj në qytet -kishite disa njësi pune por edhe disa miniera për përpunimin e tyre si ajo e hekur-nikelit në Përrenjas-Fshat, Miniera e Nikel-Silikatit në Pishkash, Sektori Minerar i Bushtricës dhe Skroskës. Banorët u sistemuan dhe kështu siguronin jetën. Pas vitit '90 të gjitha këto u braktisën dhe fshatarët, tashmë të kthyer në qytetarë u përpoqën të bëjnë bizneset e tyre në sektorin e shërbimeve, blegtori, bujqësi dhe gjithashtu edhe në shfrytëzimin e pyjeve. Kuptohet një pjesë fare e pakët sepse të tjerët thjesht sorrollatën dhe sorollatën pafund.

### Zënit

Tashmë jemi më shumë njerëz dhe makina e prishur na jep mundësinë të rrimë më tepër. Një çift austriak, që ka mbërri-

tur sakaq, mundohet me këmbë e duar që të merren vesh me kamerierin sesi vazhdon rruga për në Tiranë. 'Strategu' ka heshtur. Një vendali, që na jep të njohur, bën variantin e tij të zonës. Është nga një prej fshatrave të Rajcës. Kjo e fundit është pjesë e një komune, e cila nuk mund të shfrytëzojë këteje e tutje shumë nga burimet e saj. Dikur në internet kam hasur një shkrim shumë ofendues të një funksionari të saj ndaj Përrenjasit. Edhe ky M.G. ish punonjës miniere nga Rajca më flet me urretje për Përrenjasin, por i ka zët gazetarët. Të duket pak si urretje palestinezësh për hebrenjtë dhe anasjelltas. Kur u bënë këta? Në fakt Përrenjasi u zhvillua shumë dhe e la pas Rajcën që bën gjumin e saj shekullor me pronat dhe zhvillimet e saj. Komuna e Rajcës u bë e njohur në vitet '90 me vrasjet e djemve, që edhe sot e kësaj dite fatet e tyre s'janë zbardhur plotësisht. Maqedonët pretendonin se ata bënin kontrabandë armësh, ndërsa vendasit thjesht cigare... Por Rajcianët tashmë s'u dalin vetëm këto. Banorët e Rajcës ankohen për gjithçka për ujin, që s'ua japin në administrim; për kufijtë dhe për padrejtësitë. "Edhe mbi fshatin Ladorisht, në Strugë është një pllajë e tërë quhet edhe sot 'Gështenjat e Bogdanëve të Rajcës'", thotë burri me triumf.

Fëmijët, që kanë ardhur nga Uraka, një fshat në këmbë të Qafë të Thanës, pak u prish punë kjo. Dhe, këto zënie komunash, fshatrash, ende as ua prekin botën feminare. Të çudit çiltërsia e vajzës, që e di se mundësia e vetme për të ikur nga ky vend është vetëm martesja dhe çlirimi i ngadalë i djemve, që tash bëhen shumë që thonë se të gjithë duan të ikin. Po këtu vallë kush do rrijë? Burrave u humbasin fjetet.

Në kohë të vjetra thuhej se në këtë vend ishte një vend special blatimi ose orakujsh në Qafën e Thanës, ku orakuj të lashtë parathonin fatin e njerëzve dhe ndodhive. Kuptohet se burrat nuk e dinë këtë, por të gjithë sipas mundësive, në këtë verë të freskët në Qafë Thanë e tregojnë sipas tyre. Thjesht, Qafa e Thanës (interpretohet se e ka marrë emrin nga vendi i të thënës) duket se e mbron vendin nga erërat e ftohta, ndërsa përballë i bëhet barrierë liqenit me puhitë e turbullta që ngre në dimër. Rajcarët duan toka në doganën e Qafë-Thanës, që sot kanë mbetur shtetërore. Janë mbi 15 ha tokë, për të cilat s'u njihet për asnjë arsye tapitë dhe ca më pak që ti certifikojnë. E vetmja referencë për vendin më vjen nga një shkrim i Dr. Zeqos: "Studiuesja austriake, Eleonora Vagner, profesore në Universitetin e Vjenës, ka shkruar se kjo shpellë është shpella e një orakulli të lashtë. Ajo mbështetet në dy argumente aspak arkeologjikë por thjesht të rrafshit linguishtik. Ajo mendon se fjala Urakë është një metamorfizim i fjalës orakull. Një ekuacion i tillë nuk është i saktë dhe është i pavërtetueshëm. Argumenti i dytë lidhet me emër vendin Qafa e Thanës. Gjoja kemi të bëjmë me një formë të tillë si "Qafa e të

Thënës", duke mëtuar se e Thëna shpreh kështu funksionin e orakullit. Edhe ky shpjegim i një etimologjie vulgare popullore nuk qëndron", shkruan Moikom Zeqo. Mbase kjo e zbut të gjithë dhe e lë çudinë...

### E gjithë zona

Është e çuditshme, që në këto ditë vere, sepse vetëm gjen ankime te banorët. Por është kështu. Të gjithë ankohen. Duket se të gjithëve u bëhen padrejtësi. Vetëm shqiptarëve. Austriakët presin, që t'i shoqërojë një çift kryeqytetasish drejt Tiranës. Një mësues, me të cilin do ulëmi pak orë më vonë, do më zbardhë një historik të thjeshtë, ku më shumë se fjalët, ideja mbetet e njëjtë: njerëzit më shumë flasin se punojnë. Argumenti është i thjeshtë. Të gjithë tokat s'punohen si duhet, ndërsa njerëzit duan thjesht të ikin. Komuna e Rajcës përbëhet nga fshatrat Rrajcë-fushë, Rrajcë-Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh, Urak dhe është një nga 9 komunat e Librazhdit. Ka një lum me emrin Lingajci, që e përshkon mes për mes fushës së Domosdovës. Pyjet e këtij vendi janë nga më të begatët dhe bashkë me pyjet e Steblevës dhe Stravajt përbëjnë një ndër 5 zonat më pyjorë në vendin tonë. Por vendi ka bimë mjekësore pa fund si sherbela, çaji, dëllinja e kuqe dhe e zezë dhe lule, që janë të gjitha burim jete. Ka një kompleks me 4 liqene akullnajtore me gjatësi 100 m dhe gjerësi 80 m dhe në këto vende kanë kaluar segmente të rrugës antike Egnatia. Psh stacioni i Qafë-Thanës quhej Glaudanon. Kurse Rruga Kandave ishte rruga pararomake drejt rrjedhës së Shkumbinit, në trasenë e të cilës do ngrihej Via Egnatia. Të gjitha këto s'mjaftojnë që gjithsesi këta njerëz të pushojnë dhe të punojnë dhe të ngrenë jetesa të mira. Mësuesi preferon të heshtë. Fëmijët kanë mbetur të shushatur disi....

### Dikur, njësoj

Në një udhëtim në këtë vend, që pastaj e përcjell me emrin 'Dy vagabondët', John Gordon do të shkruajë:

Duke vajtur në Pogradec me kuaj samari padyshim, ndalen në Qukës, te një hanxhi dymbëdhjetë vjeç

-Ç'ke hanxhi të na japësh?

-Gjithë, ç'urdhëroni. Ve, qumësht, bukë djathtë, mish. Kemi nga të gjitha edhe mish të pjekur.

Po shkuan edhe tridhjetë minuta dhe asgjë nuk vjen.

-Ku i ke vezët?

Pulat janë në katund.

-Po hiq e i merr.

-S'di në kanë pjellë sot!

-Po mishin?

Dhëntë po kullosin, tani vjen tufa, zemë një qengj dhe e therrim...Pas dy orësh hëngërëm bukë kallamboqi dhe pak qumësht.

### Në vend të fundit

E kemi nisur për një shpjegim ushtarak, por me banorët që hasim, gjendemi në malin e ankesave të pafundme se nuk punohet. Se nuk ia vlen! Të tjerë që harxhojnë pa fund ujin. Dhe të gjithë pastaj kundër të gjithëve. Fëmijët kanë humbur në bisedat e të rriturve, që tashmë si zakonisht na marrin me detyrim në kafe. Askush nuk thotë dot se çfarë flet më bota e tyre feminare dhe se çfarë shembulli i duhet. Dikush ka lajmëruar vajzën që të kthehet. Me të ikën dhe djali. *Perëndim i vagëlluar /Në katund kërcet një derë/Në liqen hesht një lopatë/Një shqiponjë e arratisur/Fluturon mi Mal të Thatë...*

Ah, sikur të ishte kaq thjeshtë. Ky përfytyrim idilik i Lasgush Poradecit do të më mjaftojë dhe për Domosdovën dhe për fjalët tona sesa vështirë e kemi të ngremë pa u penguar një civilizim normal. Kujtoj fqinjët maqedonë që janë shumë më parë dhe ky më ngjall trishtim. Madje, edhe pakoha e këtyre banorëve përballë. Është verë e vitit 2010.

Ben ANDONI  
(Marrë nga revista "Mapo")



## Tregim nga Istref HAXHILLARI

(vijon nga numri i kaluar)

**M**e dhimbje ndërmendi arratisjen e bujshme, të nëmur; veshët i buçitën nga britmat, ulërimat, zhurmat e armëve. Dhjetëra njerëz të armatosur grumbulluan burrat në sheshin përfaqësimi. Pas këmbimit të fjalëve pa krye, taksidari i egërsuar e zuri për gryke të atin, zgjedhur i parë në fshat.

-Nxirni bereqetin e fshehur, - tha me kërcënim.

-Nuk ka bereqet të fshehur, as të pafshehur, - mezi u përgjigj plakui.

-Shteti mbahet me detyrimet tuaja.

-Kur s'ka nuk merr as mbreti, - psherëtiu me keqardhje kryetari i fshatit.

Taksidari e vështroi vëngër. Ky burrë i vjetër, i gjatë si shkop tallej me qeverinë.

-Ka edhe mënyra të tjera, - hungëroi.

Tjetri ngriti supet i habitur.

Ndihmësi i taksidarit, një burrë i egër me mustaqe të shpëlara, e shtrëngoi plakun sa i dolën sytë, e përplasi pa frymë për tokë. Brahu ia qas të atit, po një shkëlqim i fortë ia sollti mendjen vërdallë. Iu mbajt fryma, rënkoi i ndërkryer. U ngrit me shpejtësi, nguli thikën e harkuar në barkun e kërcyer të mustaqelliut tinëzar, në aq pak kohë sa të tjerët nuk arritën të bënin lëvizjen më të vogël. Gjysmë i shkalluar, pa përfillur rrezikun, i vuri tehu në fytyrë taksidarit. Nga të gjitha anët u drejtuan armët e mbushura.

-Thuaju të hedhin pushkët, - ulëriu

Tjetri e pa veten në thonjtë e djalit shtatmadh si ndonjë div. Thika i gërvishhte qafën, gjuri i Brahos e torturonte në fund të barkut.

Të dërguarit e qeverisë u larguan, po lanë ankthin e zymtë.

Fshatarët mbajtën frymën. Brahu ia çmendur. Të prekej shteti!? Askush nuk mund të hahej me të, aq më pak një fshat i vetmuar. Pleqët s'mbanin mend të turpërohej kështu fuqia e shtetit. As në kohën e mbretërisë nuk pati ndodhur. Shumica, veçanërisht besimtarët e moshuar dhe bestytët më të rinj, pandehën se djali ngriti dorën kundër Zotit.

Me trupin e gjatë, mustaqet e zeza ngritur përpyjet, duart muskulozë dhe ballin e lartë, Brahu u mbështet në trunqun e manit. Shpërfill gjykimet e heshtura. Thika i vajti në kockë dhe gjaku në tru, bëri atë që duhej.

-Kush dëshiron le të më ndjekë, - tha me të butë. Njëmbëdhjetë djem iu bënë shokë.

-Këtë rrotull, - u foli me të mirë burrave, kthyer në statuja të ngurosur rrotull manit.

I ati e përqafoi me dhembshuri.

-Bir i babait, - e puthi përmes lotëve.

Pas një muaji fshatin e përmbytën forcat e armatosura. Ndjekësit iu qepën këmba-këmbës. Në përpjekjen e parë u vra Sokoli. Trupin ia sollën në fshat, e masakruan në sy të njerëzve. Babai plak nuk duroi thikat mbi trupin e djalit të vvarë, vdiq atë ditë në mbrëmje. Mori me vete në varr brengën e hidhur të lemerishme.

Ndjekja në thellësi të pyllit u përsërit, po djemtë shpëtuan.

Emri i Brahos u përhap me shpejtësi si shiu thatësirës stërgjatë verës së nxehtë. Fshatarët e shihnin me shpresë flakëzën e re. Taksat u merrnin frymën. Shteti nuk u besonte, i kërcënonte gjithnjë e më shpesh.

Shumë shpejtë revolta përmirë qeverinë.

Braho Fordina e ndjeu më tepër se sa e kuptoi gjëndjen e koklavitur. Do të përmbysnin gur mbi gur t'i kapnin, kundërshtia nuk kishte të ardhme. Mblodhi shokët e mbetur. Me leshrat e gjata, trupin kaba dhe zemrën copë qëndroi gurit plloçak si sofër.

-Ikni, - u tha, - më kërkoni mua, ju nuk jeni fajtorë.

# Vallja e kapedan Fordinës

U larguan të gjithë atë natë. Kur mbeti vetëm u strehua në Shkëmbin e shqiptonjave.

Jetonte me mish gjahu dhe vezë shpendësh. Ushqime i sillnin rrallë kur firaksin ndjekësit. Koka e tij paguhej shtrenjt. Nuk ishte e lehtë të ndihmoje kundërshtarin e qeverisë; spiunët përgjonin.

Nguli sytë i trishtuar në hapësirën tej shkëmbit.

-Dhjetë muaj, - mendoj, - nuk u mërzuam?

Mugëtira erdhi përmijherë pis e zezë. Bashkë me natën behu sërish shtrëngata, nisi këngën vajtuese era e lartësive, e vetmja muzikë e lartësive.

-Eh, or mik, si do të vejë filli? - iu drejtua Prijësit.

-Ti nuk je si ata, - i tha dhe bëri me dorë andej nga duhet të qenë ndjekësit.

E bëri zakon të fliste me zogun çdo natë derisa e mberthente gjumi mbështjellë me gunën e dhirtë. Thurte plane, shpesh ëndrra me sy hapur, kërkonte mendimin e aleatit murrash me njollën e kuqërremtë në krah.

-Krra, krra, - zgjati kokën zogu, pastaj mprehu sqepin në qosh të guvës.

-S'i thonë shaka, luftë me shtetin, - u mburr Brahu.

Prijësi i shqiptonjave futi kokën mes krahëve.

-Të flihet, - i tha me qesëndi, - sa gjumash je?

Mbrëmja krodhi në gjysmëterr shpellën. Majat mavi të maleve të rrudha, mbuluar me dëborë, vizatoheshin në horizontin e zbehë të ku endej akoma pasqyrimi i muzgut.

Në qiellin e errësuar yjet e rrallë nxirnin kokën midis reve të zeza. Zotëroi heshtja. Vetëm suferina vazhdonte këngën e mërzuatshme të njëlojtë. Diku nga perëndimi ndriçimi zvetënues i diellit të padukshëm rrinte varur mbi pyll. Me dritën vezulluese të valëzuar drithëronte krejt botën e përçudnuar nga thellimi. Kur u shua e fundmja regëtimë drite, qielli erdh u bë ngjyrë jargavani e blu, terrina pushtoi vendin. Tutje pyllit treftej muzgu vagëllues, hija dendësohej gjithnjë e më shumë. Sytë iu mësuan me zor në gjysmërrësirën larushitur nga e kuqërremta e flakëve.

Afër mëngjesit e zunë dridhmat, mbërdhima i hyri në palcë.

-Buisi shkurti, - tha me vete.

Në fshat shkurtin e quanin muaj të zi.

Rregulloi kërcunjtë, i fryu prushit të shkëmbuar. Dëborë pushoi. Në lindje u ravijëzuan turbull grumbuj resh ngecur në qafa malesh. Dita, në agun e saj, hapte udhë përmes të çarave të qiellit. Dalloheshin vagëllimthi drurët mbuluar me shapka dëborë. Gremina të hatashme misterioze vizatoheshin përreth në formë njollash të zeza. Mjegullat, përdredhur si gjarpërinj, zvarrëshin nëpër rrudhat e trasha të shkëmbinjve të afërm sikur ndjenin të frikësuar afrimin e ditës.

Pas pak gdhui, pushoi era, furtuna reshiti. Zgjati kokën, vështroi qiellin e kthjellët pa dëborë. Nën dritën e ftohtë dimërore derdhi shikimin i mallëngjyer mbi pamjen e mrekullueshme të agimit. Hyrja e zgavërt fuste me zor përflakjen kaltëroshë. Re pluhuri drithmonin mes mbeturinave të zjarrit.

Formacioni i përbindshëm shkëmbor i shpellës, granit i lëmuar përgjatë kohës së pamatë prej erës dhe shirave, ngrihej frikshëm nga thellësitë. Shndriste në një të kuqe të kërmëzët bakri, a thua guri pati marrë flakë dhe prushitej nga të brendshmet e tij. Në zbardhëllimin e mëngjesit i dukej sikur mes flakëritjes së kontureve të pyllit dallonte njerëz e kafshë që fërgëllonin.

Ndjeu gëzimin e lirisë. Në pritje të zbutej akulli nën diellin e legëndisur, u vu të vëzhgonte me nge fshatin.

Afër mesditës vuri re lëvizje të pazakontë nëpër rrugë. Një flakë e madhe shpërtheu te sheshi ku lartohet mani. Nuk ndodhte të ndizin zjarr jashtë mes dimrit. Në pranverë digjin koskutat e misrit, barin e kalbur, mbeturinat e dushkëve. Pastronin arat për mbjelljet e reja. E mbuluan kujtime të ëmbla, vegime të shkuara, siç i ndodhte dendur së fundmi. E pa veten fëmijë tek grumbullonte ferra, rrënjë barishtesh të egra, degë të thata. Ndizte zjarr mes arës si ky i sotmi. Zemra e kallkanosur

nuk duroi. Dhjetë muaj me egërsirat, pa zëra njerëzish, larg shtëpisë dhe të afërmeve. Qielli i kaltëruar, ndriçimi i bardhë, ajri i kristaltë ia ngatërruan kohërat.

Uli kokoren e rrekosur të gunës. Bëri një hap në dalje të shpellës, vështroi me vëmendje shkallët e rrëpirëta. Akulli zbutej me zor, squllej ngadalë. Parandjenja të frikshme e shtynë të kuturiste. Filloi zbritjen me ngulm, rrëshqiti, nguli thonjtë nëpër gurë, gjakosi duart.

Zoti e shpëtoi nga rrokullima në humnerë.

Zjarr vazhdonte të fekte përmes xhamave të tejgyrës. Përndjeu të vërtetën e hidhur; kërcënonin fshatin.

Mbi lumin e mpakur takoi Lanin.

-Frikësojnë me zjarr, - i tha.

Braho Fordina nuk foli. Hoqi armën nga supi, shtiu pa iu dridhur dora. Shigjetat e zjarrta të plumbave çanë qiellin tejpertej.

-Ç'bërë! - u mblodh Lani.

Tjetri i vuri dorën në sup dhembshurisht.

\*\*\*

Gjyqi e dënoi me varje publike. U munduan të zbulonin lidhjet me armiqtë e shtetit, fijet e komplotit, bashkëpunëtorët. Nuk besonin dhjetë muaj arrati vetmitare.

-Me se ushqeheshe? - e pyetën.

-Me mish gjahu, - tha Brahu.

-Po dimrit?

Nënqeshi i habitur.

-Vendosja leqë nëpër shtigje, - u përgjigj, - ngahera ngrejmë kurthe në fshat.

-Ku strehoheshe?

-Në Shkëmbin e shqiptonjave.

Dërguan njerëz panë vendin. Ngrehina shkëmbore e thiktë u ngjethi mishtë.

-Atje nuk kacavaret njeriu, - i thanë.

-Unë u ngjita.

E shikuan mosbesues, këmbëngulja i nervozoi. Akuza për rrëzimin me dhunë të qeverisë e çuditi.

-Me qeverinë nuk pata gjë, - kundërshtoi.

-Vrave grumbulluesin e drithit, - i thanë, - preke shtetin.

-Shteti nuk i djeg njerëzit e tij, - u inatos Brahu dhe heshti.

Tërë ato pyetje të çuditshme, pa kuptim.

-Ku s'u shkon mendja! - mëmëriti me vete i sëndisur.

Pranvera e atij viti s'u ngjante të mëparshmeve, vinte disi e vonuar. Pemët sapo sythëzuan, me zor çelën lulet e kumbullave nëpër lugina, arrat dimëronin ende. Shkumbini flinte në shtratin e mpakur. Nga maja e Kozicit era ngjishte ca re ngarkuar me lagështirë dhe çast pas çasti fironte dritën e diellit. Vështirë të kuptoje nëse pati shkelur pranvera.

Në shesh sollën banorët e pesëdhjetë fshatrave. Njerëzit dyndeshin indiferentë, më shumë për t'u dukur. Ashtu si qindra copëza të jetës së njerëzve, prania në shesh lidhej me pëlqimin e qeverisjes. Fshati i tij erdhi vetë. Të mëdhenj e të vegjël donin ta shihnin edhe njëherë; e kishin të afërm, u dhimbsej.

Aq njerëz bashkë Brahu nuk kishte parë kurrë. Sikur vinë për dasmë mendoj i ligështuar. Në rrëshetin e parë Shqipja e zverdhur fshinte sytë e buavitur me shami. Të ëmën plakë e mbanin për krahu. Gra të tjera qanin në heshitje fshehur, sikur turpëroheshin nga lotët.

Hodhi sytë përreth. Janë mblodhur për mua u drodh së brendshmi. E ndjeu deri në thellësi të shpirtit; vajtonin mortin e tij. Ishte dhe nuk ishte mes tyre. Frikën e vdekjes e mendonte po kurrë nuk besoi të qe kaq e llahtarshme. Asnjëherë s'kish patur si tani etje për të jetuar. Kaq shumë gjëra të thjeshta jetësore do të zhdukeshin.

Me zor mposhti plogëstini që po e mpynte.

Dikush e zgjidhi. Fërkoj kyçet e duarve, ngriti flokët e gjatë rënë mbi sy. Turma ndiqte çdo lëvizje e përgjendruar.

-Si do të prishet kaq i ri, i bukur! - pëshpëriti dikush.

-Shpirtin po ia marrin njerëzit, jo Zoti, - tha një tjetër, me sa dukej hoxhë.

-Gjynah, - mëmëriti dhe ngriti sytë nga qielli.

Në qetësinë e përmortshme u dëgjua një zë i thatë si tingull teneqeje.

-Çfarë ke për të thënë?

Djali shikoi me habi fëmijësh. E ç'mund të thoshte? Se aty në shesh një vajzë e priste? Apo sa shumë i donte njerëzit, malet, fshatin e tij? Kush nuk i dinte këto?

Vështroi përfaqë i mallëngjyer. Donte të merrte sa më shumë imazhe, të mos linte asgjë pa soditur çastet e fundit. Vuri re një gjethe të tharë kumbulle ngjitur në këpucë. Shikoi një copë herë fletëzën e gjoër që fërfëllinte në erë. Druante se do të shkëputej dhe fluturonte, po ajo qëndroi me ngulm kapur në një cep.

Oh, sikur të ndalej hapi i kohës, të mos vinte kurrë ai çast i tmerrshëm! Pikëllimi rritej si ortek, i shqyente zemrën.

Ngriti kokën me mundim.

-Dua Lanin, - tha.

Zbatuesi i ligjit s'e kuptoi, u mat të kërkonte sqarim, po vuri re djalin që u shkëput nga turma me çantë në dorë.

-Ky qënka tjetri, - tha me vete.

Lani nxori nga trasta fustanellat, kapat dhe këpucët, të gjitha të bardha borë. U afrua edhe një plak thatanik i krrusur me gjajde, pas tij dy të tjerë me fizarmonikë dhe daulle. Brahu i shikoi me dashuri. Harroi vdekjen. Përkëdheli me sy xha Metin, deshi ta falnderonte me gjithë shpirt; po i lehtësonte çastet e fundit.

Plaku e puthi me dorë dhe lëshoi tingujt e gjajdes. Të tjerët e ndoqën.

Në mes të sheshit buçiti melodia e njohur. Brahu lëvizte këmbën e djathtë, u mbështet mbi supin e shokut, nisi këngën.

"Plot molla lule të bardha..."

Lani u përkul nën peshën e rëndë, e shoqëroi më lëvizjen e këmbëve dhe mbajti ison e këngës.

"... Hej lule të bardha..."

Pastaj Brahu kërcëu përmbi kokën e tij. U drodh në lartësi, qëndroi mbi njëren këmbë të përkulur, ndërsa gjuri tjetër preku tokën. Trupi kaba rëndoi mbi Lanin. Nga rrjeshti i parë u dëgjua një "oh" e zgjatur. Brahu e shikoi fluturimthi në ajër me sytë e qeshur çapëkë në sikur i bënte isharet. Pastaj u hodh përpara. Lani e ndiqte në të gjitha ato spërdredhje të holla.

-Dil i mblidh moj çupë e re, - oshëtiu zëri i djaloshit nën hijen e litarit që lëkundej me pulsion e valles.

-Unë i mbledh po s'kam në se, - e shoqëroi Lani dhe ndoqi ritmin.

Qindra njerëz përcillnin vallen e vjetër sa dheu mokrar. E kishin parë të hiqej nëpër dasma, navigje, fejesa, po kështu nuk qe luajtur kurrë. Në shesh zotëroi qetësi varri. Sy e veshë ndiqnin magjinë e valles së Braho Fordinës, kapedanit të këngës.

Kur mbaroi, gratë dënesën me zë të lartë, nuk u fshehnë më. Përmbi të gjitha u dëgjua një zë i dridhur plake, ngritur në këmbë me shami dorës së djathtë.

"Jam zgjuar apo në ëndërr

Bir të bëri nëna dhëndërr..."

Me dorën tjetër shkulte leshrat e hirta të kokës.

-Të marton nëna me litarin, - u çorr me zë të vajtur.

-U çmend, - tha dikush.

Të tjerat e shikuan me inat.

Vajzës së alivanosur i hidhnin ujë.

Ç'ishte kjo gjëmë? Të varej kënga, të shuhej vallja?

-Jepini fund, - mezi u dëgjua të fliste zbatuesi i ligjit.

Zëri iu drodh dhe uli kokën.

Brahu shikoi në litar i lehtësuar si besimtarët që rrëfëhen para vdekjes.

Nga degët e arrës stërmadhe përqosh sheshit u sul vërtik një shqiptonjë. Njerëzit vështuruan të tmerruar xhelatin e përgjakur; ulëriu dhe fluturoi nga dërrasat e trekëmbëshit. Në vend të syve, hapur dy gropa të zeza. Zogun e met-altë me sqepin e kthyer e vunë re të largohet me shpejtësinë e plumbit vetëm disa. Më pas nuk ishin të sigurt në se e panë vërtet.

Braho Fordina e pikasi Prijësin përpara se të kridhej në degët e shtrembëra të arrës. E ndjeu nga krakëllima e mbytur.

NJË RRËFIM PËR NJERËZ TË THJESHTË QË TASHMË NUK JANË MË MIDIS NESH/ HOMAZH PËR ANASTAS LIGOR PIHONIN

# Shkëlqesi, pi një gotë për shpirt të babait!

Nga Koço PIHONI

I shte vjeshtë e vitit 1940 kur Shqipëria ishte e pushtuar nga Italia fashiste e drejtuar nga Benito Mussolini-Duçja. Në ato vite të pushtimit, Italia fashiste rekrutoi e mobilizoi gjithë të rinjtë shqiptarë që kishin mbushur moshën mbi 18 vjet, të aftë për të kryer shërbimin ushtarak nën armë. Fati i keq e solli që unë të bëja shërbim ushtarak për gati një vit nën armë në ushtrinë italiane. Gjatë asaj kohe, unë e shumë shokë, për disa muaj, ne si regjiment këmbësorie ishim të dislokuar në fushim me çadra në rrethinat në Vorës, atje unë, Anastas Pihoni, me tre shokë të tjerë në një çadër, së bashku me Beqir Ballukun, Boris Perçini nga Peshkëpia e Tasi Kostallarin". Babai tregonte se në atë kohë Italia u jepte të gjithë ushtarëve në drekë, veç të tjerash, një gjellë me mish dhe një garuzhde me verë. Duhet t'u them se një pjesë e ushtarëve, refuzonin ta merrnin mishin për shkak të bestyt-nive se ai mishi ishte shpesh prej derri apo prej njëthundrakësh e verën nuk e dëshironin të gjithë, kjo edhe për shkak të moshës së re. Ne të katër shokëve që ishim me moshë 22-24 vjet dhe me gradë nga tetar e lart, shpesh në çadrën tonë, vinte na vizitonte edhe komandanti i regjimentit, që ishte major Spiro Moisiu. Ne kishim bërë një rregull, çdo ditë në kohën kur ndahej dreka një apo dy shok nga ne, shkonim në sporteli i mencës dhe të gjithë ata që nuk e pinin verën ishin të lutur ta shtinin në atë bidonë që ne jua ofronim, po kjo gjë dhe për ata që refuzonin ta merrnin racionin e mishit për arsye që thashë. Paragjykimet që kishin mos ai ishte prej derri apo njëthundrakësh, prandaj dhe në çadrën tonë, o diku në një vend jashtë saj, çdo mbas dite deri në mbrëmje vonë, vazhdonte të hahej e pihej të bëhej dollia sikurse bëhej nëpër gostira. Në një nga këto të shtruarat në mbrëmje, unë i bëj një brum me një gotë me fund Beqos dhe e uroj atë duke i thënë: "Gëzuar e gjithë të mirat, u bëfsh ç'të do zemra! Ishalla u bëfsh mbret, o Beqo, se Naltmadhënia Zogu e theu gafën e tradhëtoi këtë popull e Shqipërinë!" Beqiri qeshte e tha si shumë më lartësive! "Jo, i thashë, Përse? Benito Mussolini, Duçja ishte "kovac" dhe u bë Perandor, a thua se është burrë më i mirë se ti ai Duçia, o Beqo?!"

Kur unë me Beqon po pinim këtë gotë, para nesh kalon një ushtar italian, duket se ai kish qenë kalabrez dhe dinte shqip dhe e kuptoi që unë u talla me Duçen. Ai vjen e më godet mua me qytën e armës në gjoks. Mua, për një çast, mu mbajt fryma për disa sekonda, më pas si e mora veten u ngrita mora një shishe verë dhe iu sula atij kalabrezit e si e arrita, e zura për veshi, dhe ia veshja me atë shishen prapa qafës sa më



Anastas Ligor Pihoni

hëngri krahu. Ai ra përdhe shakull, pa ndjenja. Thashë se vdiq, por më pas me ndihmën mjekësore që iu dha, u përmend e më pas sqaroh njerëzit e komandën se dikush e kish goditur me diçka në kokë prapa qafës. Menjëherë u dha alarmi dhe u kërkua që i gjithë regjimenti të rreshtohet. Ndërkohë Beqiri i raportoi të vërtetën komandantit Spiro Moisiut. Spirua e urdhëroi Beqirin që të më vendosnin në çadrën e tij, pastaj urdhëroi të kontrolloheshin të gjitha çadrat, përveç asaj, ku ndodhesha unë që ishte çadra e Spiro Moisiut. Mbasi u lajmërua komanda lart, arritën me tricikla karabinierë të shumtë nga Tirana edhe për shkak se u bë natë ata u larguan pas disa orësh, për t'u kthyer ditë tjetër për të gjetur e ndëshkuar fajtorin me 25 vjet burg ose me pushkatim. Gjatë asaj nate, me datën e asaj "dite "Spiro Moisiu, lëshon një urdhër transferimi ku unë e Boris Piliçi, transferoheshim me një shërbim në një pikë shërbim në Librazhd, të qarkut të Elbasanit. Ne pa zbardhur dita u larguam nga fushimi i Vorës në vend transferimin e ri deri sa u normalizua situata. Më pas nga fundi i vjeshtës të atij viti, regjimenti ynë mori urdhër për të kaluar në jug-lindje të vendit, ku arritëm pas disa ditë marshimi.

Kur ne mbërritëm atje në zonën e Devollit, erdhi një urdhër nga komanda e lartë italiane, ku urdhërohej që regjimenti ynë i këmbësorisë duhej të kalonte kufin të mbështete një batalionin italian që luftonte në tokën

greke që ai të mund të avanconte më në thellësi. Komandanti i një-sive tonë ishte me gradë toger. Ai pasi na komunikoi urdhrin e komandës italiane, vendosi mitralozin e lehtë në pozicion zjarri dhe urdhëroi që të gjithë ne të kalonim lumin për të hyrë në tokën greke e më pas t'i bashkoheshim forcave italiane. Lumi ishte shumë i fryrë nga shirat e rënë ishte i pakalueshëm. Ne u ndodhëm midis dy zjarresh: ose të mbyteshim të gjithë, ose të qëlltoheshim nga gryka e mitralozit që kish marrë urdhër të qëllonte. Në këtë situatë të jashtëzakonshme mbërrin komandant Major Spiro Moisiu, pasi ishte informua për situatën, ai ju drejtua atij togerit dhe i kërkoi t'i raportonte dhe pasi i foli shumë rëndë iu drejtua: "Ne të gjithë jemi vëllezër, jemi shqiptarë, dhe nuk kemi përse të bëhemi palë me një ushtri pushtuese e të luftojmë nëpër familjet e tyre dhe të jenë të gatshëm në qoftë se i thërret e lyp nevoja për lirinë e atdheut tonë të pushtuar, për fatin tonë të keq nga fashistët italianë!"

Dhe ashtu u veprua, u dezertua ai front i luftës, falë mendjes, trimërisë e patriotizmit të atij komandanti patriot e atdhetar. Ndonëse ai ishte oficer për momentin në atë ushtrinë të huajsh dhe ngarkohesh me

përgjegjësi ta paguante me kokën e tija. Ai diti të veprojë e të marrë përgjegjësitë për fatin e bashkëatdhetarëve në atë moment udhëkryqi. Më pas atij dezertimi nga ushtria italiane në kthim për në familjet tona, mua e dy shokë të mi na ndaloi një patrullë ushtarësh karafilakësh greke, në afërsi të Korçës, ata pasi na ndalojnë, na çarmatosin e pasi morën vesh që ne ishim ushtarë të Italisë, na internojnë pas disa ditësh nga Korça në kampin e përqendrimit në qytetin e Selanikut të Greqisë. Në një kamp përqendrimi të sigurisë të lartë, të thurur me tela me gjemba dhe me kushte shumë të këqija strehimi dhe ushqimi. Atje na u desh të jetonim disa muaj.

Gjatë kohe të ndodhur në këtë kamp e solli rasti fati që unë të njihem me një vajzë greke të veshur në të zeza, komandantin e atij kampi përqendrimi ishte një i afërmi i saj. Ajo vajzë, ishte aq e bukur "sa t'ia prisje kokën", e shkolluar dhe familje shumë e "pasur". Dua ta "theksoj" këtë, se asaj vajze i kish ndodhur një fatkeqësi e madhe në familje. Në luftë i ishin vrrarë babai e i vëllai dhe jetonte e vetëm me nënën e saj. Ajo vajzë trashëgonte e vetme një pasuri shumë të madhe, kishte disa dyqane manufakturash e disa magazinat që duhej dikush t'i administronte. Ajo femër, pasi u njohëm bashkë u dashurua pas meje "marrëzish", duke marrë shkak mbase dhe nga pamja ime me tipare të rregullta nga flokët e mi të gjata dhe komunikimi me të në gjuhën greke e arumune prej së cilës ishte dhe gjeneza e nënës së asaj vajze. Prandaj dhe kur të gjithë të tjerët rrezikoheshin për ushqim, ajo çdo ditë më sillte mua, veç të tjerash dhe dy, tre çokollata të mëdha sa pëllëmba e dorës sime dhe më lutej ajo vajzë mua, më përgjerohej, t'i jepja fjalën, t'i jepja besën që unë të vija "kurore më atë" dhe nuk kish asnjë problem, për sasinë e paraja që do duheshin për të më liruar nga ai kamp përqendrimi grek. Ndaj edhe sot, pas 60 vjetësh që kanë kaluar, unë atë histori dashurie nuk e harroj, por kam thënë e përsëri e them: Në qoftë se unë kam vuajtur e do vuaj në këtë jetë, mendoj e besoj se më kanë zënë mallkimet e asaj femre aq të dashuruar pas meje, sepse unë asaj të mire i rashë me këmbë. Sot unë them, se vetëm se atëherë unë isha i ri, se ndryshe nuk di si ta shpjegoj, ose mbase ishte e thënë kështu. Për ta jetuar këtë jetë. Për të cilën unë do t'ju rrëfej një sekret të mbajtur të fshehtë në jetën time. Sipas një "falli" të shtënë nga unë në atë kohë atje në Greqi nga një fallxhore a profete. Fjalët e thëna prej saj më kanë dalë pik për pik. Deri sot me gjithë se kanë kaluar gati 60 vjet nga ajo kohë deri në vitin 2000 që ne po flasim bashkë. Unë së bashku me një shokun tim Demir Ditën nga fshati Trebinjë e Mokrës, duke shfrytëzuar një

natë të errët e me shi, vendosëm të arratiseshim nga ai kamp përqendrimi. Me ndihmën e një palë pincave që na ranë në dorë, premë disa tela dhe mundëm të arratisemi, mbasi më shumë se dhjetë orësh ecje udhëtim më këmbë, nëpër errësirën e asaj nate e një shiu që rrodhi për gjithë natën, në mëngjes kishim arritur në një qendër të banuar në periferi të Selanikut. Atje shkuam të dy në një lokal për të ngrënë diçka. Mbasi hëngrëm mëngjes dhe mbasi e morëm disi veten nga lodhja e rrugës e pagjumësia Në afërsi të atij lokali ndodhej një godinë e veçantë nga të tjerat, një tempull i lashtë me një mjedis për rreth me qiparize. Atje brenda në atë tempull, vërtet kryhej një shërbim i veçantë. Ai që shërbente brenda kishte aftësi e dhunti hyjnore, do të thosha më tepër se ajo mundësonte e të shikonte e lexonte në pëllëmbën e dorës, fatin e të thoshte të paditurat e asaj pjesë të ngelur të pajtuar të jetës për fallshtënesit të shkruar në ditën e tretë pas lindjes së atij personit. Kjo fatinë ishte një grua zonjë rreth të shtatëdhjetave, me pamje të hijshme e të shëndetshme, me flokë krejt të thinjura që e bënte atë të ngjasonte si një qenie hyjnore. Në shoqërimin e saj ishin e dy fatina të tjera, diçka më të reja. Ajo qëndronte e ulur në një poltron të drunjte me krahë mbështetës të punuar me gdhendje, figura e simbole para kishtarë ku dukshëm dallohej Zeusi, Apolloni e tre fatinat e Dodonës si dhe figura mbretërishe e gjeneralësh që ishin të interesuar të mësonin për fatin e mbretërive të tyre a të betejave të ndryshme të zhvilluara sipas orakujve të asaj kohe. Mbi tavolinën e ndodhur para asaj prej dru are me punime të gdhendura në atë dru. Atje shihje të vendosur shumë libra të shkruara në greqishten e vjetër, gurë të çmuar nga vende të mira, erëza, temjan e shishe me vajra, miro e verëra etj. U bëra kureshtar dhe pyes një nga ato dy murgeshat, nëse shtinte fall ajo fallxhore? Në filxhan me letra apo në ndonjë shpatull bagëtie a parmë shpendësh? Jo, më thanë, ajo si objekt kryesor ka "pëllëmbën e dorës" tuaj dhe vëzhgon e prek e disa pjesë trupore, se trashësinë e lëkurës e ngjyrën e saj, gjatësinë e trashësinë e gishtave, hundën, veshët, ngjyrën e syve dhe të flokut etj. Si dhe ne saj të njohurive e dijeve në shumë në fusha të ndryshme të dijeve, më pas ajo përcaktonte kostitucionin, temperamentin dhe impaktet që kishin ato në leximin e asaj morie vijësh që ndodhen në atë pëllëmbën e dorës të gjithë secilit, atje ajo pastaj lexonte çfarë kanë shkruar ato fatinat për të thënë e fatin tuaj.

Vendosa të paguaja vleftën e duhur për të mësuar si është e shkruara e panjohur në pëllëmbë të dorës time.

(vijon në faqen 11)

JETESHKRIM MBI NAUM THANAS GEGPRIFTIN

# Ideator dhe realizator energjik

Nga Herolinda Shkullaku

Naum Thanasi Gegprifti ose sic e njihnin dhe e therrisin te gjithë profesor Nuci, lindi ne 30 qershor 1943 ne Potkozhan ne familjen e Thanasi e Polikseni Gegpriftit duke iu sjelle atyre gezimin e madh te lindjes se nje djali pas 6 vajzash.

Thanasi, i cili ishte dyqanci dhe kishte levizur shpesh per pune neper Shqiperi, sigurisht neper Moker por edhe deri ne Kucove, ishte vendosur tashme ne Pogradec. Familja e ndoqi me pas kur Naumi ishte ende foshnje. Megjithese banonin ne Pogradec, Polikseni ngjitej gjithmone ne Potkozhan duke marre dhe femijet me vete sepse nuk mund te rrinte pa punuar edhe token qe kishin ne fshat.

Ne moshe ende te re, rreth 59 vjec, Thanasi largohet nga kjo jete, duke e lene Poliksenin me 3 femije ende te parritur mire (2 vajza dhe Naumi, kishin mbijetuar kurse te 4 femije kishin vdekur ende foshnja) Sigurisht qe jeta nuk ishte e lehte per t'u perballur dhe Naumi nuk ishte i huaj per veshitese te saj, megjithë kujdesin e jashtezakonshem te 2 motrave, Florikes e Polkes, dhe nenes se vet.

Pasi mbaron gjimnazin ne Pogradec, Naumi fiton bursen per te studiuar per anglisht ne Tirane, dhe gjate veres punonte per te ndihmuar edhe familjen qe po i mbeshteste me sakrifica studimet e tij. Ne vitin 1965 pas mbarimit te fakultetit te gjuheve te huaja, nga nje kateder qe po nxirrte diplomantet e pare ne vend, Nuci emerohet mesues ne gjimnazin e qytetit te tij.

Shume shpejt ra ne sy zgjuarsia dhe intelekti i tij jo i zakonshem dhe inklinacioni i natyreshem per te mesuar shume shpejt gjera te reja.

Nje djalosh 30 vjecar nga mesues gjimnazi ne Pogradec shkon si punonjes ne Ministrine e Jashtme duke mbuluar ceshtjet e Ballkanit perkrah diplomatëve te vjeter qe kishin studiuar jashte si Dhori Samsuri apo Nesti Nase qe e perkrahen per meritat dhe miresine e tij. Me 1973 emerohet i Ngarkuar me Pune ne ambasaden shqiptare ne Kube. Aftesite e tij te vecanta diplomatike dhe gatishmeria per te mesuar vazhdimisht gjera te reja, per fat te keq nuk munden te vazhdonin me tej megjithë karrieren e merituar dhe te shpejte.

Ne nje kohe kur here pas here ne Shqiperi goditeshin grupe te ndryshme „anti partiake”, nuk ishte aq rastesore edhe fakti qe Naumin e transferuan familjarisht ne Gojan te Pukes per 3 vjet. Si mesues ne shkollen e mesme se bashku me gruan e tij Floren, djalin 4 vjecar dhe vajzen e porosalindur, me thjeshtesine dhe komunikimin e tij te rralle, arriti t'i beje vend vetes edhe ne kete ambient te ri e aq te ndryshem



nga i pari. Fakti i dergimit te tij ne Puke, shoqeruar edhe me largimin e tij nga partia, e ndoqen gjate gjithë kohes se periudhes se partise se punes. Ndonese nga te paret mesues te gjuhes angleze ne Shqiperi, dhe nder te rrallet qe kishte patur mundesine ta praktikonte ate jashte shtetit dhe me nje zoterim te shkelqyer edhe te spanjishtes, Naumi nuk u kthye me kurse si mesues ne gjimnazin e qytetit.

Gjate periudhes si mesues i gjuhes angleze ne shkollen e mesme bujqesore ne Remenj e me pas ne Bucimas, ai iu perkushtua me shume vullnet e kembengulje punes per te nxjerre ne drite nje fjalor spanjisht-shqip-spanjisht. Ne dimrin e ftohte te Pogradecit mbuluar me batanie ne gjunje ne apartamentin e tij per balle liqenit, mbi tavolinën e madhe te ngrenies se familjes ne mes te dhomes, zhytur mes te fjaloreve te medhenj ne disa gjuhe, te cilat mezi i kishte siguruar permes njohjesh nga jashte shtetit, dhe qindra fleteve formati e fletoreve panumer, Naumi punoi per 10 vjet me rradhe. Ky fjalor nuk arriti te botohet ndonjehere, megjithese u dorezua ne shtepine botuese ne Tirane, pasi shtepia botuese i deklaroi „te humbura” nje pjese te doreshkrimeve origjinale te tij... Nje pune kolosale, ne nje kohe kur nuk ishin botuar ende fjalore te spanjishtes, e cuar dem nga „pakujdesia” e institucioneve pergjegjes, ne nje periudhe kur Shqiperia po ndjente dritherimat e para te ndryshimit te sistemit te hekurit.

Ne fund te viteve '80, u sëmur nga nje paralize e pjesshme e gjymtyreve. Gruaja e tij, Flora iu gjend prane per 2 muaj me rradhe ne spitalin e Tiranës. Ishite vetem nje mrekulli dhe hiri i Zotit qe ai i mbijetoi asaj semundje qe mjekohej vetem me... vitamina. Nje prove per vullnetin e tij te hekurt qe te fillonte te ecte perseri nga e para, pasi muskujt ishin gati te atrofizuar nga semundja.

Pas semundjes filloi pune ne hotel-turizmin e qytetit si hotelier, shoqerues per te huajt, pak kohe si drejtor e me pas si manaxher i tij. Vitet e liberalizimit dhe vizitave te grupeve te para te turistëve dhe me pas edhe levizjeve te para te te huajve. Nje

jashtezakonshem qe shume shpejt ka per ta marre veten nga shoku i ndryshimit te regjimit.

Nje njeri qe dinte ta vleresonte jeten, njerezit dhe momentin, me nje inteligjence dhe guxim te rralle, profesor Nuci ishte i pari ne Pogradec qe kuptoi rendesine e angazhimit civil ne nje shoqeri te hapur. Ne vitin 1996 me iniciativen e tij, nje grup intelektualësh te shquar te Pogradecit i dhane jete shoqates civile « turizmi dhe mjedisi ». Pofesor Nuci, i kishte diskutuar shpesh here me drejtues te ministrise se turizmit dhe madje i kishte edhe publikuar mendimet e tij mbi strategjine per turizmin shqiptar qysh heret, por

studentëve, deri ne shoqata homologe ne vendet fqinje, duke nxitur bashkepunimin mes vendeve nderkufitare.

Ideator teper pjellor dhe realizator energjik, anetar i disa bordeve per manaxhimin e liqenit dhe bashkepunimin nderkufitar, arriti te realizojte projekte te shumta e broshura qe ofrojne informacion te detajuar mbi monumentet e natyres se rrethit, te cilat u identifikuan per here te pare, traditat e zones, analize e shkaktareve te ndotjes se liqenit dhe sesibilizimi per zgjidhjen e problemeve mjedisore. Zyra e profesor Nuci ishte hapur per cdo keshille dhe informacion per cdo mik, shok a qytetar te thjeshte qe donte dicka prej tij.

Energjia e tij e pashtershme u ndal vetem ne dhjetor te 2005, gjate festes se veres ne Pogradec ku ishte i preokupuar per panarin e vlerave kulinarike te zones, nje projekt ne kuader te nismes “qytet krijues” mbeshetur nga fondacioni serioz “pro Helvetia”. Semundja qe u shfaq aq befasisht mbremje te ftohte dhjetori, duke se nuk kishte filluar per here te pare aty. Ajo perparoi shume shpejt dhe te gjithëve ende nuk na besohet qe eshte ndare nga kjo jete.

Ndoshta per te gjithë ne qe ia ndjejme mungesen e nje keshille, e nje mendimi, e nje ideje e nje qeshje, e nje perqafimi... ishte nje largim i heret. Megjithate, njerez si profesor Nuci qe me merite kane gjetur vendin e tyre ne cdo sistem apo kohe te jetes, njerez si ai qe i kane lene vend vetes qofte me nje njeri te thjeshte qe e takonte vetem nje here per nje hall apo nevoje, qofte me nje te ri qe ka perspektive por mungese pervojë, qofte me nje specialist, diplomat apo njeri me emer. Njerez te tille edhe pse nuk i kemi prane fizikisht, ne nje menyre apo ne nje tjetër vazhdojme t'i kemi me vete dhe nuk mund te shkeputen prej nesh, deri sa te jemi...



person aq mendje hapur e me nje bagazh te vecante njohurish si profesor Nuci, nuk mund te ishte ne nje vend me te pershtatshem si ai ne kohën me te pershtatshme. Te huajt e pare qe vizitonin Shqiperine dhe ne itinerarin e tyre edhe Pogradecin, nje pjese gazetare apo shkrimtare kurioze e nje pjese delegacione zyrtare me interes per te ndihmuar kete vend te posahapur, shpesh here merrnin me vete impresione te pashlyera nga takimet me profesor Nucin, impresione te tilla qe i benin te shkruanin kur ktheshin ne vendet e tyre, se nese Shqiperia ka te tilla kualitete e rralla ne provincat e saj, me siguri ishte nje vend me njerez te

duke kuptuar ngurtesine dhe mosvazhdueshmerine ne dikasteret shtetërore, zgjodhi shoqerine civile per te ofruar kontributin e tij modest ne kete drejtim. Ai iu perkushtua deri ne fund te kesaj jete angazhimit dhe iniciatives shoqerore ne krye te shoqatave « turizmi dhe mjedisi », « ne gjurmët e trashigimise » dhe per shume kohe edhe si kryetar i Forumit Lokal te OJF.

Gjate ketyre viteve ai gjalleroi me projekte te ndryshme mjedisore e promovuese te turizmit e vlerave kulturore e natyrore te zones. Me aftesite e tij te jashtezakonshme komunikuese arriti te perfshinte ne keto aktivitete qe nga te rinjte e shkollave te mesme e

## LIBRI "SLABINJA JONË,, ËSHTË NJË MONUMENT LETRAR PËR NE

Nga Vait SINANI

Unë që po ju shkruaj, jam një banor i fshatit Slabinjë, banoj aty. Kam punuar shitës për një kohë të gjatë, deri sa dola në pension. Tani banjo në fshatin Slabinjë, dhe merrem me pronën time private, nuk rri dot pa punë, dhe deri tani nuk jam ndarë nga puna.

Djemtë i kam me punë dhe me shtëpi në Pogradec, e Tiranë, por unë këtu e ndiej veten më rehat. Djemtë më vijë dhe më vizitojnë shpesh, edhe unë shkoj tek ata por nuk rri shumë gjatë. Më 20 gusht 2010 në fshatin Slabinjë takova djalin e fshatit zotin Zenun Fero, bideova bashkë me të për disa probleme, ashtu siç bisedojnë dy njerëz kur takohen me njëri tjetrin. Por nuk e la pa shkruar, se ky djalë, ka punuar për Slabinjën, si në gazetën "Mokra" por ai i ka bërë fshatit një monument, një libër monografik "Slabinja Jonë" në vitin 2005. Ai i ka lënë brezave që do të vijin një diçka të shkruar, ajo do të ngelet brez pas brezi, Siç ka punuar Zenuni, duhet të punojnë të gjithë.

Librin "Slabinja Jonë" e kam lexuar disa herë, dhe e lexoj herë pas here, e ka trajtuar shumë mirë dhe me bazë të plotë reale. Fshati Slabinjë ka tani një monument të plotë, nga rrjedh dhe historia e tij. Këtë e krijoi Zenuni, e i falemindërit shumë. I uroi krijimtari më të mirë. U takuam më 20 gusht 2010, tek familja e Pëllumb Sinanit, i cili kishte ardhur direkt për t'i sjellë familjes disa gazeta "Mokra", që shkruanin për familjen në vitin 2008, të Thëllënza Sinani.

Edhe pse koha ka kaluar, familjes nuk i kanë mbaruar lotët, qajnë të gjithë, kur lexojnë shkrimin e Zenun Feros, që gjithë Mokra përcjell në banesën e fundit Thëllënza Sinanit. Nuk duhet ta kishte larguar zoti ashtu. Ajo ishte një tragjedi e madhe, u dëgjua në të gjithë Shqipërinë. U ndamë me Zenunin, ai shkoi tek Zyber Bego ish korieri i fshatit, për ti dërguar disa gazeta "Mokra" ku shkruanin për postjerët e Slabinjës.

Me këtë rast i uroi gazetës "Mokra" suksese, merrni masa dhe na shpërndani edhe neve nëpër fshatra. Ne e duam, ajo është pasqyra e jetës sonë urime të gjithë stafit të saj.



Poezi nga Jeton MUÇOLLARI

## Në vargjet e mia

PARTIZAN 16-VJEÇAR

Hodhe pushkën përmbi sup,  
Trimi ynë partizani,  
Ende pa hedhur mirë trup,  
Se të thërriste vatani.

Po të vritesh për Shqipëri,  
Nëna për ty s'do qajë,  
Nëse bën ndonjë marrëzi,  
Zemra peshën s'do ta mbajë.

Nëpër gjumë, si rrufetë,  
I shkrepëtinin këto fjalë,  
Ndaj se thyenë vështirësitë,  
Gjashtëmbëdhjetë vjeçarin djalë.

Kur i thanë se e kishin rrëmbyer,  
Valët e egra të Shkumbinit,  
Me dhimbje tha nëna e fyer,  
S'do më thonë nën' e trimit.

Kush shpirtin ja tronditi,  
Me këtë lajm' të pa qënë,  
Në dimrin e atij viti,  
Gjakun helm ia bënë.

U kalit nëpër beteja,  
Në përleshje me armiqetë,  
E shenjtë ishte Shqipëria,  
Sa se ndalën as stuhitë.

Në të përgjakshme luftime,  
Grimë frike si kish mbetur,  
Zjarr e prush tek zemra trime,  
Djaloshi ynë kish gjetur.

### NE VARGJET E MIA

-bashkëshortes-

Mbi supet e heshtjes fjalët djallëzore qëndruan,  
Këngën e braktisjes me zell të madh kënduan,  
Pa pyetur për burgun e përjetshëm vetmi,  
Do të murosej trishtueshëm i pafajshmi njeri.

Dhe sot e kësaj dite kësi këngësh këndohen,  
Ndonëse mbytur në sfond, sa mezi dëgjohen,  
Presin të kalbet, të tretet ndjenja e dashurisë,  
Të këndohet, dëgjohej veç himni i zisë.

Mbi hije dyshimi djallëzitetë vegjetojnë,  
Statujën e ndërgjegjes, të lëkundin, të rrëzojnë,  
Përmendoren e sakrificës rreken ta shëmbin,  
Llafazanët, intrigantët, jo kurrë se trembin.

Eh...Frym kjo erë e marrë, do fryjë pa pushim,  
Mburojë është dashuria, s'e venit asnjë trishtim,  
Monument në shesh edhe mund të ngrija,  
Por më gjatë do të rrosh në vargjet e mia.

### NATA

Rrezet e diellit ngjyrë floriri,  
Tretën tutje në horizont,  
Shuhet ngadalë gjigandi qiri,  
Perdja e zezë bije në sfond.

Pelerina e çjerrë e errësirës,  
Me miliona vrime shpuar,  
Na mbulon kundra dëshirës,  
Yjet në të bukur stampuar.

Do ta ndezë agimi i mëngjezit,  
Gjigandin qiri përsëri,  
Coha e zezë, nga këng' e këndezit,  
Zhduket si me magji.

Përsëritet ky ritual ngaherë,  
Pa e komanduar asnjëri,  
Sa ditë e natë të kemi përherë,  
Për ne do mbetet mrekulli.

## OHRI-QYTET QË I BËRI PËRSHTYPJE TË JASHTËZAKONSHME KONSULLIT JOHAN GEORG VON HAHN

Nga Zenun FERO

Konsulli perandorak i Autro-Hungarisë në trojet shqiptare Johan Georg Von Hahn, mbërriti me anije nga Trieste në Durrës më 5 mars 1885. U vendos në Durrës në shtëpinë e një komisioneri austriak që merrej me tregëtin detare i quajtur Tedsikini, dhe vizitoi Durrësin.

Mbas disa ditësh në shoqërinë e shqipëtarit Ahmet Beqiri, dhe të një kolegu austriak Balerini filluan të vizitojnë Shqipërinë. Vizituan Tiranën, në Priskë e tjerë. Nga këto vizita ishte edhe ajo në Ohër, Lyhndid, që tani quhej Ohër, ata qëndruan gjatë. Ky qytet i bëri një përshtypje të jashtëzakonshme Hahnit. Aty e priti patriaku i patrikanës së Ohrit dhe autoritetet turke të administratës.

Mësuesi Gjergji Borgli në Ohër i tregoi për monumentet në Ohër. Vizitoi Katedralen e Shën Sofisë, rezidencën e Patrikanës. Katedralja që e stilit bizantin dhe brenda kishte afreska të mrekullueshme. Në muret e jashtme kishte monumente të murosurat antike, ndërsa në mjedisin e katedrales afresket kishin mbishkrime, kryesisht citime nga psalmet.

Në Kishën e Shën Klementit, të Shekullit XIV-të në mbishkrimet e saj lexoi se këtë kishë e kishte ngritur princi shqiptar Zaharia Gropa në shekullin e XIV-të. Në kishë brenda ishte një skulpturë druri e Klementit të Shenjtë. Kjo e habiti Hahnin, sepse kishat ortodokse greke nuk e pranonin ekzistencën e skulpturave të shenjtore, por vetëm afreskat dhe mozaikët. Skulptura e Klementit që një perjashtim, rasti i vetëm në gjithë teritorin e ish perandorisë bizantine.

Në kishë Hahn pa një Epitaf, trupin e krishtit të vdekur që qëndruar në fije ari me një pelhurë mëndafshi. Sipas mbishkrimeve të epitafit që dhuratë nga perandori Andronit në shekullin e 13-të. Epitafi kishte përmasat 1.6 m dhe gjersi 1.15 m anash kishte dy engje me fletë që qëndronin në këmbë, me duar të vendosura mbi njëra tjetrën dhe të ngritura lart. Këtu ishin dhe figurat e shkrimtarëve ungujllorë,



Meteut, Gjinit dhe Lukas, por mungonte Marku.

Koleksioni i librave të kishës përmbante 144 dokumenta, rreshtat e shkruar me bojë jeshile, tregonin të shkruarat e patriakve. Aty ishte edhe lista e tre patriakëve deri në vitin 1664.

Hahn, në takimet që pati dëgjonte ç'thoshin bashkëbiseduesit mikëpritës, për politikën, ortodoksën dhe kuranin. Të gjithë kishin një mirëkuptim të paimagjinueshëm. Priftërinjtë ortodoksë qenë të kujdesshëm, nuk provokonin, ndërsa autoritetet turke qenë krenare, por i shmangeshin konfliktit. Në këto takime u fol edhe për Shën Erazmin e Shenjtë, njeri nga shtatë oshnarët e Ohrit që kishte spikatur krahas Shën Klementit dhe Shën Naumit. U bisedua edhe herezitetë e ndryshme që kishin kërcënuar kishën.

Në Kishën e Shën Klementit, Hahn për të vetmin imazh monofyz të Krishtit. Heretikët monofyzë njihnin vetëm anën hyjnore të Krishtit, e mohonin natyrën e tij njerzore. Afresku e paraqiste Krishtin si një Kryengjell ose më saktë si mbretin e të gjithë kryengritjeve. U habit, si kishte mbijetuar ky imazh, pse nuk qe shkatërruar.

Në takimet që pati, Hahnit i sillnin monedha dhe unaza të vjetra. I bënë përshtypje monedhat prej argjendi të Aleksandrit të Madh, të Amytas, por edhe të perandorëve britanikë, sidomos të Justinianit. Një monedhë i takonte dhe Teodorikut të Madh.

Teodoriku i Madh, ishte një

goti fuqishëm, mbreti i Rovenës. Në Durrës kishte kushuririn e tij, Sidimund dhe qe sundimtar i fuqishëm i qytetit Epidamn në shekullin e VI-të. Ishte vasal i Perandorit të Bizantit, merрте pension nga Konstadinopoja, kishte gradën e domestikut, ishte një ushtarak dinak dhe i pathyeshëm. Teodoriku e bindi që të shkëputej nga Perandori i Biznatit dhe të lejonte trupat gotë nga Rovenat të pushtonin qytetin e Epidamnit.

Këtë Sidimundi e pranoi dhe e zbrazti qytetin e Epidamnit, por e lajmëroi Teodorikun se ushtria bizante kishte reaguuar dhe kishte vendosur kampin e saj në qytetin Heraklea. Në qytetin e Lynidit u zhvillua një luftë midis dy forcave gotëve dhe bizantëve, ku gotët u thyen. Pas kësaj humbje Sidimundi bashkë me ushtarët e tij shkoi në Dardani.

Kjo histori e pjesëshme tregon se sa situatë e ndërlikuar ishte në tokat e shqiptarëve nën sundimin e perandorisë së Bizantit. Hahn u kthye nga Ohri dhe shkoji drejt Shqipërisë Veriut. Udhëtimi i gjatë i Hahnit vazhdoi trembëdhjetë muaj, duke u kthyer përsëri në Janinë, ku kishte Zyren e tij Konsullore.

Në fund të udhëtimit të tij që zgjati 15 vjet, Hahn botoi ne Vjenë korpusin e tij me shumë libra të quajtura "Studime shqiptare,, . Ai kuptoi përfundimish se shqiptarët qenë një popull si gjithë të tjerët të vjetër. Hahn u nda nga jeta më 1869, në moshën 49 vjeçare . Çdo gjë e tij mbeti vetëm në librat që ai shkruajti.



LETRA TË NJË EMIGRANTI/HOMAZH PËR XHAXHAIN TIM, QEMAL BUFIN

# Mall, dashuri dhe dhimbje për njerëzit dhe vendlindjen

**Z**oti Fahri Bufi, prej vitesh ka emigruar në Romë të Italisë, por përherë ka qenë dhe mbetet i interesuar për gazetën "Mokra", dashamirës i vendlindjes, ndër sponsorët e parë të saj. Këto tre vitet e fundit ai e ka ndjekur gazetën nëpërmjet internetit dhe në numrin e 140, na dërgon shkrimin plot dhimbje e brenga për humbjen e xhaxhait të tij, Qemal Bufit nga Kriçkova. Më tepër sesa në portret – homazh për këtë njeri të afërt e të dashur të tij, të cilin ai nuk pati mundësinë t'i gjendej pranë në çastet e fundit të jetës, shkrimi është njëherësh një nostalgji, një mall dhe një vlerësim për vendlindjen, për atë që la pas e që e zgjon dhe e frymëzon herë pas here. Kështu është fati i emigrantit. Gjithsesi e urojmë dhe Fariun për ndershmërinë, aftësinë për punë si fizioterapist e masazhit, që në këtë rast fati është me pacientët italianë. Fariu dhe bashkëshortja e tij Leta po bëjnë një sakrificë të madhe për shkollimin e vajzës dhe të djalit, të cilët janë vlerësuar nga fakultetet si yje shqiptarë, vlerësim të larta që kalojnë edhe studentët italianë. Njëherësh redaksia i shpreh edhe ngushëllimet e saj Fahriut si dhe mirënjohje e respekt!



Qemal Bufi

**M**ëngjes i datës 2 tetor. Lexoj ne celular mesazhin e dërguar nga im nip Geni: "... sot ndërroj jete xhaxha Qemali...". U trondita shume dhe mendova: përsëri me gjeti larg ky lajm i zi, ashtu si për vdekjen e prindërve të mi e mjaft të afërmeve të tjere. Me sa duket kam arritur ne një pikë të jetes sime që, verej se po humbas te afermit dhe miqtë, me nje shpejtesi gjithnje e me te madhe. I rashe telefonit te shtepise se Qemalit, me shprese se mos kish ndonje gabim, por jo, ne anen tjetër te tij, degjoja zerin e kushuririt Lutfi qe me beri te qarte çdo gje, pra kish ndodhur ajo qe s'e prisnim. Ngushellova xhaxhain e vogël Hamdiun qe, u ndodh aty e priste njerëzit, mbylla i pikelluar telefonin dhe siç ndodh ne kesi rastesh e humba fare, nuk dija çte beja...

Dhimbje e dyfishte, për humbjen e xhaxhait dhe për pamundësinë për ta përcjellë siç do të doja une, për ne banesën e fundit. Te renda janë keto momente tragjike për të gjithë, por behen akoma me te renda për emigrantin, i cili mendon e vuan qe s'mund te jete pranë njerëzve te aferm, për te ndare me ta dhimbjen. Natyrisht mendoj se ashtu si une Qemali kish shume, duke filluar nga fëmijët e tij e deri niper e mbesa, te shpërndarë neper bote e qe, s'do te kene ndoshta mundësi te jene se bashku me fëmijët e gruan e tij te zonja, Beharen tone te dashur, si bashkëshorte e përsosur dhe si nene ideale.

Lotet janë te pa evitueshëm, ata rrjedhin çurk pa e kuptuar edhe për ne burrat, sado qe inkurajojme njeri tjetrin me fjalet: "Qendro si burrë!". Ato fjale s'mjaftojnë. Dhimbja behet me e forte kur mendoj qe trunget te familes sime ju keput edhe nje dege. Nje proverb amerikan thote: "gjethja e nje peme s'mund te zverdhet e te keputet, pa e ditur me pare e gjithë pema". "Pema", d.m.th. ne, e shihnim qe ai ankonte ndonje shqetësim kohet e fundit, por ishte gjithmone i kujdeseshëm dhe nen kontrollin e mjekëve, pra, i konsideronim keto si "pa qeder," apo "te moshes." Por, jo! Ato paskan qene sinjale te pameshirshme për mbylljen e portes se jetes se Qemalit tone. "Bir, jemi mysafire ne kete bote! Jeta eshte sa çel e mbyll syte. Vdekjen e kemi hak."

Thoshte nena e tij dhe gjyshja time. Kur i degjoja ne femijeri këto fjale, nuk arrija ti kuptoja mire, bile pafajesisht e me naivitetin e moshes mendoja qe vdekja nuk do te arrinte kurre gje tek familja ime, ndersa tani, i jap te drejte asaj gruaje te mençur. Vertete kështu qenka jeta. Qemali u lind nje dite te premte (me fat, siç thosh ai shpesh) ne Kriçkove, midis njerëzve punetore e te zote si ata, por edhe te kenges e muzikes qe, kur ktheheshin nga puna te lodhur, derdhnin pa kursim kenget e melodite baritore me fyej, ketyre instrumenteve te lashte popullore te mreklulshem. Nje nder ta qe edhe babai im, por qe, siç me tregonte vete ai, nuk e zuri me me dore fyellin qe kur i vdiq njeri prej dajove te tij, me te cilin kish qene shume i lidhur. Megjithese nuk degjoja babane tim te interpretonte me fyell, une u rrita dhe jetova ne kete ambient duke degjuar fyelltaret virtuozë Nuri Klogjeri e Qeram Fejzollari qe, edhe zogjte e pyllit nderprisnin fluturimin për ti degjuar. Ne femijet dhe te rinjte e asaj kohe degjonim me endje melodite me tambura (sic ju themi ne) te xha Veliut e xha Nuriut si dhe femijeve te tyre. Ky pra qe terreni qe kultivoi tek Qemali pasionin për kenget e muziken tradicionale mokrare, te cilave nuk ju nda asnjehere. Kriçkoven, kete fshat te vogël, fati e ka vendosur ne brinjte te Pelionit antik, historia e te cilit kish ngelur e mbyllur brenda verrezave te gurte nder shekuj. Edhe për brezin tim, kjo histori e varrosur nuk njihej. Ne benim shpesh eskursione, me mesuesin e pasionuar te shkollës fillore Muharrem Bufi, për te njohur bukurite e natyres se Gradishtes siç quhet sot, apo mblidhnim copeza enesh argjile te pjekura ,te shperndara rrotull. Vetem kaq. Me tej asnje shpjegim për historine e saj, ajo vazhdonte te ngelej e fshehur për ne. Kurse për emrin Gradishte, qe tingellonte pak si çuditshem dhe te vriste veshet, as qe mund ta mendonim se ç'kuptim kishte kjo fjale. E kush te na i shpjegonte? Me vone mesuam qe ishte fjale me prejardhje sllave, sigurisht e ndryshuar pas dyndjeve te hordhive te tyre barbare, për te bere te harrohej emri i bukur Pelion. Ne po rriteshim dhe gjate pushimeve te veres kalonim shpesh ne ato ane, pa e ditur ende qe nen kembet tona

kish varre te fshehura. Veçonim për te luajtur, sidomos njerin prej ketyre ambjenteve qe, kish formen e nje shpelle te gdhendur e qe ne e quanim "Quari i Begos". Imagjinata jone prej femijesh, s'mund te shkonte deri atje sa te mendonte qe, pikerisht aty nen te, ruhej edhe nje amfiteater e rrotull saj, disa varre te gurte te mbuluar nga dheu. Kjo gje u be e njohur për ne, ashtu si për te tere, vite me vone. Ishte njeri prej fisit Kume qe dha i pari lajmin e qe u hapi pune arkeologeve. Mandej u desh talenti dhe puna e palodhur e mikut dhe shkrimtarit mokrar Haki Balliu qe, megjithese me pak te dhe na arkeologjike e arkivore, arrin ta ktheje ne art kete histori, duke i bere nje sineteze te plote asaj, për PELIONIN. Nder me i madh s'mund ti behej Mokres nga nje pene e birit te saj. Pasi lexon me nje fryme c'ka shkruar Hakiu për te, te krijohet deshira, por edhe bindja qe, pena e tij s'ka mbaruar ende pune me Mokren, te lene ne harrese, pse te mos e them: dje dhe sot. Pra, ketu u lind dhe u rrit Qemali, ne kete territor dhe Kriçkova, se bashku me njerëzit e saj shpalosi jetesen e vet me gezime dhe hidherime. Ai pati dy prinder te thjeshte, por te ndershem e te sojme. I ati gjysh Tosuni ishte njeri me zemer te mire e bujar, qe s'ja gjeje shokun ne tere zonen, siç me paten treguar mjaft te moshuar bashke kohes te tij. Ai duke mos ja dale mbane te perballonte jeten shume te veshitore e te varfer, mori rruget e mergimit qe shpejt e megjithate, s'mundi te zbusse fukarallekun e madh te asaj kohe. Arriti vetem te blente ca toka qe, prodhonin sa për te mbajtur frymen gjalle. Ka vuajtur zona jone edhe për buken e gojes! Dhe si për te mos i mjaftuar keto vuajtje, ai mori pjese ne te dy luftrat e fundit boterore. Gjysh Tosuni vdiq, duke lene Qemalin dhe vellain e vogël Hamdiun ende pa u berruar. E jema, Zymbylja, bije e fisnikeve Llapushi te vendosur ne Somotine, te zbritur aty ne ate vend, te bute e begate nga Verça. Ate "e sakrifikuam" duke e martuar ne Kriçkove, për ta pasur afer bijen dhe motren e vetme te kishin e jo ne Stamboll, ku e paten kerkuar për nuse. E ajo ngeli bije e denje e atij fisi deri sa vdiq ne moshen 90 vjecare. U martua ne Kriçkove, për nuk e gezoj martesën, sepse shpejt e shkulem bashke me tere fshatin, për ti nisur ne udhen e gjate drejt vendeve te panjohur te Ballkanit te veriut. I syrgjynosen me dhune forcat ushtarake nderluftuese, pasi krahina jone ishte fushe beteje për ta. U nisen muhaxhoret e ngrate duke veshtruar pas me dhimbje, sepse lane ç'do gje te tyre te shtrënjte, pa ditur nese do ti shihnin me vatrë e tyre... Rruget deri ne Struge me tregonte gjyshja, e bene me kembe e qe aty me tren u nisen drejt veriut, kaluan Kerçoven, Ysqypin (Shkupin) Kumanoven duke vazhduar me tej deri sa arriten ne nje kamp te mallkuar... Ajo perseriste shpesh: "Mire qe s'pata femije se do ti kisha lene rrugeve si shume te tjere..." Po megjithate edhe ata si familje, nuk i shpetuan fatit mizor te ktheheshin pa gjysh Nexhipin vjehrrin e saj te cilin, si me i dobeti dhe i moshuari qe ishte, vdekja e pati me te lehte ta marre me vete, duke e varrosur ne nje varr pa emer, ne dhe te huaj... Ndersa kur u kthyen ne fshat, e gjeten ate krejtësisht te shkaterruar. Kish ngelur vetem xhamia e fshatit dhe shtepia dykateshe e Fejzollareve qe sherbente si banese për oficeret. U desh ta fillonim perseri çdo gje nga e para me tregonte ajo grua e mencur, e zonja dhe e sakrifices, nga e cila ne pasardhesit e saj mesuam shume. Perrallat dhe tregimet e saj pa fund nxisnin mendjen tone te virgjër me deshiren për te degjuar me vemendje e

lexuar sadopak. Eh sa pak kishim ne brezi im për te lexuar ne ate kohe! Sa pak libra kishim! Disa nga ato qe me pat treguar ajo, i gjeta me vone ne librat e te madhit tone Kuteli... E tille qe dhe ngeli ajo, me mendje te holle e te kthjellët, me pleqeri te bardhe e rrethuar nga dashuria e femijeve dhe niperve te shumte te saj, qe e deshen e i deshi aq shume. Eshte e kuptueshme qe, duke pasur nje nene te tille, nxuri shume edhe Qemali yne. Une i kam perjetuar lidhjet e forta te Qemalit me te jemen, jo vetem si lidhje gjaku e trashëgimije, por nga qe siç thashe babaj i tij e la akoma te pa berruar, ai u lidh aq shume me te. Nga e jema trashëgoj cilesite me te mira, mori nga ajo menyren e te treguarit, apo si themi ne mokraret: te ngaret e llafit. Thone gjithashtu qe, ne te rite e saj qe edhe e pashme (sidomos e shikuar me syte e mi), nga pat marre edhe Qemali. Te rralla ishin lidhjet e tij me dajot e tij, trima e bujare te Somotines. Te veçanta ishin marredheniet e Qemalit me babane tim Nexhipin i cili, duke qene femija i pare, pas vdekjes se babajt te tyre, u be njekohesisht edhe "baba" edhe vella i me te vegjelve. Qemali i donte, respektonte dhe i nderonte shume prinderit e mi si dhe vellezerit e nenes sime, prej fisit Korça te Debrovës. Keto ishin arsyt qe, une kisha marredhenie te veçanta me te. Dashuria dhe respekti i nderdjellte i kater vellezerve Nexhip, Vesel, Qemal, Hamdi dhe motres se vetme te tyre Nafije ishin te pakrahasueshme. Degjoja shpesh ne fshat e me gjere te thoshin "si filanet" d.m.th. si djemte e xha Tosunit. Flisnin gjithmone ne shkallen siperores, duke qene ende femije, me shtohet krenaria për ta. Une pata fatin te rritesha ne nje familje te tille, se bashku me Qemalin e duke qene edhe nipi i pare, mora nga shembulli i tij guximin dhe forcen për te perballuar jeten. Ai nuk ishte si i thone fjalet "uje i vaket," por ish me nje temperament vullkanik qe perbuzte çdo frike e rrezik. Atij, dhe kete e kam perjetuar vete, i mjaftonte vetem nje çorape e leshte për te futur doren ne te dhe te kapte edhe gjarpërin me helmatises, neperken e shullerit. Ne kujtesen time ngelet ai Qemal i zgjuar e ironik kur duhej, simpatik dhe i forte e me nje fizik për tu admiruar. Ai kishte gjithashtu prirje natyrore te zinte miqesi me çdo njeri, te çdo "sere," përçmonte oportunitizmin, nuk shihte interesa, duke mos pertuar te hynte edhe ne çadren e Sefedin gjadexhiut (kurbatit), apo edhe duke mbajtur lidhjet me ndonjerin qe kish "probleme biografike" si njerin nga djemte e agait te Selces Fuatin qe, ishin shoke femijerie dhe e ruajten miqesine e tyre. Kur nje dite e pyeta se ku ndodhej ai, Qemali mu pergjigj: eshte ne Kavaje. I mbante lidhjet me mikun e vjeter, Qemali. Ai kish miq e shoke ane e kend, qe nga rrjedhjet e siperme te tre degeve te Shkumbinit e deri ne Elbasan e me gjere. Qemalit do ti shkonte shume shprehja popullore: "trimi i mire me shoke shume". I donte dhe dinte ti mbante e ti sajdiste miqte, ashtu siç e donin dhe e respektonin ata, sado large qe te ishin: ne Berzesh-te a Qarrishte, ne Sopot apo Verçe, ne Lënie, ne Llenge apo Gore-Opar, ne Korçe a Pogradec, ne Elbasan apo Tirane e me tej. Me ka rastisur shpesh ne rinine time te hershme te shkoja ne ato zona e duke takuar njerëz te ndryshem qe, natyrisht s'i njihja, por qe ata sapo degjonin qe isha nipi i Qemalit dhe me pyesnin si ishte me shendet miku i tyre, me drejtosheshin me fjalet: "kafeja dhe gota jote e rakise jane te paguara". Cfare mund te me jepnin me shume, respekti dhe nderimi për shokun dhe mikun e tyre e për xhaxhain tim Qemal, veç kenaqesise për miq te tille dhe

krenarise per xhaxhain? Ai nuk pertonte tu gjendej miqve ne dite te mira apo te keqia e, se bashku me kusheririn e tij (me baballaret vellezer) dhe tonin , te pa harruarin xha Kasem, niseshin per ne Berzeshten e larget ose ne Kalivacin malor ne rreze te Kozicit. Xha Kasemi ishte perhere i pranishem dhe i shume mire prituri ne konakun tone, per te nderuar miqte e ardhur qe, s'mungonin thujase asnjehere ne deren tone. Ish ai qe hapte kurdohere gezimin me kengen e tij te preferuar "ftujkez e bardha me zile" e qe natyrisht ja kthente si perhere vetem Qemali. Me kujtimet e asaj kenge une u rrita qe kur kujtesa ime filloj te zhvillohej e derisa xha kasemi u nda nga jeta. Ata te dy, ne mbyllje te dollive e darkes, hiqnin edhe vallen dyshe, sepse smund te mbyllej darka pa ate valle, sa me lezet aq edhe me humor te paperseritshem. Ishin aq ne harmoni me njeri tjetrin sa zor se mund te arrihen e te perseriten nga te tjere. Kur degjoje Qemalin te fliste, te krijonte pershtypjen e nje "diplomati" te lindur. Atij i kish lezet fjale edhe ne sofrat ku shtrohej krah e pihej rakia me dolli te zgjatura mokrare. E kush nuk do ta dëshironte ate ne nje tavoline ziafeti, sa per bukurine e fjales aq edhe per zerin e mrekullueshem ne kengen e kenduara se bashku me vella e vogel Hamdiun qe, dukeshin si binjake, ishin aq shume te lidhur me njeri tjetri e qe bene aq emer te mire? Si kengetare te Kicikovs, ata i quajten "bilbilat e Mokres" dhe bene jehone jo vetem ne zone , por edhe me gjere, duke u ngjitur ne podiumet e festivaleve lokale e kombetare. Ata me zerat e tyre virtuozte kendum kenget epike te zones, kenget lirike, kenget e kurbetit, kenget humoristike, e kenget e punes. Me keto kenge ata mbushnin me gezim jeten e varfer shpirtore te kohes. Ne veren e vitit 1973 hapa radion dhe degjova zerin e folesit te programit qe tha: -dhe tani do te degjoni kengen per Gjorg Golemin, kendum nga vellezerit Hamdi e Qemal Bufi. Qendrova ne vend dhe e degjova kengen gjer ne fund.

"Gjorgj Golemi na çon fjale  
Argjevini te na dale  
me ata trimat e mokrare.  
Kush me kembe e kush me kale,  
kush me heshte e kush me palle.  
Te marrim malin perpjete,  
te dalin te guret e gjete  
se atje kane folete."

Nuk e dija qe fonoteka e radios dhe e televizionit kishin te regjistruara kenget e xhaxhallareve te mi. Vargjet e kesaj kenge trimerie, i kushtoheshin luftetarit te madh kunder perandorise aziatike, Gjorg Golemit siç e thirren ne Moker. Ato vargje per te, te ardhura nga legjendat, ishin percjelle goje me goje nga populli deri ne ditet tona dhe u kendum per afer dyzet vjet nga vellezerit Hamdi e Qemal. Me ngelen ne mendje vargjet e asaj kenge qe i perserisja shpesh ne ate kohe. Me vone e vura ne kasete e i degjoja perhere qe, se bashku me kengen tjetere "Bilbil kur zbrete nga mali":

"Ulu o bilbil nga mali,  
ulu pij uje ne strerre.  
Merrja biblil me ngadale,  
merrja per ashikun e mjere.  
Biblil te zuri debora e prillit,  
bilbil te prishi folene.  
As ja merr bilbil njehere,  
merrja per ashikun e mjere.  
Bilbil te zuri dhemballa,  
s'u gjet doktor qe ta nzjerre.  
Merrja biblin me ngadale,  
merrja per ashikun e mjere"

Por edhe kenge te tjera i ruaj me fanatizem e i degjoj vazhdimisht kur kam mundesi, sidomos kur me merr malli per vendin tim. Kenget me zerat e tyre te veçante te ngrajne peshe, here e intonazione te lehta kur i kendum "bilbil" dhe here me intonazione te forta qe te kujtonin thirrjet per beteje, kur kendum kengen per Gjorg Golemin. Magjia e zerave te tyre dhe permbajtja e kengeve me mrekullojne sa here i degjoj.

Ne pasardhesit, nuk do ta harrojme Qemalin, per dinjitetin dhe jeten e tij te thjeshte e pa buje, ne rritjen e gjashte femijeve te tij te mrekulluehem qe, ata nga ana e tyre i dhuruan atij shume niper e mbesa po aq te mire. Kohet e fundit Qemali e Beharja u bene edhe stergjysher. Megjithese siç shkrova me siper Qemali,

ish vertet si nje lis i forte, edhe ai leshohet para mallit per femijet e larguar jashte vendit. Nje dite, koheve te fundit, kur u takuam e po flisnim pa rreshtur per hallet e dites, me nje gotez rakije perpara qe e mbante "sa per adet" siç thosh, sepse nuk e afronte me si me pare, ai mu drejtua: "edhe une jam baba, ti tani e di ç' do te thote kjo fjale, sepse je edhe vete i tille, apo jo?" Dhe humbi me syte e mbushur me lot per nje çast, nga dhimbja per ata qe i qante zemra ti kishite prane, pasi i kishte ne mergimin e larget. Vijne vetiu dhe vrullshem mendime te kesaj natyre, ato vijne nga vuajtja per femijet qe i kish large dhe lengonte siç lengon tere Mokra nga plaga e rende e mergimit. Pas nje jete 77 vjecare intensive e pune te pa lodhur, Qemali u nda nga ne. Ai nuk la pasuri, por la kujtime te mira per te gjithë ne, per femijet e tij e per te gjithë miqte e te njohurit. Une ndjeva detyrimin per xhaxhane tim, detyrimin per tu treguar brezit te katert e brezit te peste, ku bejne pjese edhe femijet e mi, ashtu siç e kam jetuar e pare une ate kohe, kur jetonte edhe Qemali yne. Po e bej me qellimin e mire dhe shpresen qe, brezat qe vijne pas, te mbajne lidhjet e gjakut, sidomos ne kushtet e emigracionit te madh, te kesaj rrjedhje masive qe u be e po vazhdon te behet ne keto kohera. Megjithese e shkruar shpejt e shpejt e me shume modesti, por me shume emociione, mendoj se eshte me mire se sa te mos shkruash fare. Ndofta neses, te tjere do shkruajne me mire, ne menyre qe brezat qe rrojne sot dhe ata qe do te vijne me pas, te njohin te kaluaren, te njohin njeri tjetrin e te mos e harrojne kurre. Per kete zgjedhja gazetave tone Mokra, si zedhenese e traditave me te mira te krahines sone. -Te mbajme njeri tjetrin, i thashe Dragushit, djalit te vogel te Qemalit, kur po flisja ne telefon me te nje dite me vone, ashtu siç dijet ta mbajne njeri tjetrin prinderit tane qe, merrreshin si model i se mires per harmonine, dashurine per njeri tjetrin, lidhjen e shendoshe vellazerore dhe respektin, fjale keto qe u perzihen me ngasherime te te dyve. Dhe une jam i sigur vazhdova qe, do ti mbajme keto lidhje, duke ruajtur traditen e familjes sone. Ne te tilla raste humbjesh te medha s'na ngelet veç te ruajme te gjalle, ate çka bene ata, prinderit tane per ne dhe te kujtojme me respekt te kaluaren, sidogje te kete qene ajo, sepse ka brenda jeten e te pareve tane, por edhe tonen, e mbylla biseden me Dragushin. Qemali pati shume endra e deshira ne jeten e tij, ashtu si tere brezi i asaj kohe e qe jo rralle u ndodhen ne udhe kryqje te jetes, ku bashke me rrudhat dhe thinjet qe shtoheshin nga hallet e dites, mbeti jo rralle ne udhe kryqje edhe dinjiteti i tyre. Por ata nuk u terhoqen asnjehere para papergjegjshmerise dhe indiferences se politikave te tere sistemeve te kohes, per ngritjen e nivelit te jeteses, duke sakrifikuar shume per rritjen e edukimin e femijeve dhe qe me durim e kembengulje ja dolen mbane. Kurse ne femijet e tyre, perfshi edhe mua qe po shkruaj keto pak radhe, u larguam nga vendi, per te siguruar buken e gojes se femijeve tane, pa harruar asnje çast edhe shkollimin e tyre. Ne keto rreshta te shkruara sot, me duket sikur fola me Qemalin, sigurisht jo me fjale ndarjeje, por me teper ishte si nje bisede e lene pergjysme. Desha te rikujtoj vlerat njerezore te tij, lidhjet e forta familjare, te tregoj jeten e thjeshte e modeste qe, ndonese e tille, ai e donte shume, pikerisht jeten e nje mokrari shkruar ne gazeten "Mokra", qe ishte edhe gazeta e tij. Neper mjet kesaj gazete, shpreh edhe nje here keqardhjen e madhe per mungesen time, per te qene se bashku me familjaret e mi e miqtë tane, te afërmit, shoket e Qemalit e tanet. Duke i falënderuar nga zemra per pjesëmarrjen e tyre ne nderimin e fundit qe ju be Qemalit, dëshiroj te them qe nderi qe i bene atij, eshte nder edhe per ata vete. Ne e patëm pike referimi xhaxha Qemalin, shkonim tek ai per tu keshilluar. Tani e vetmja pike referimi e brezit te tyre, ngeli xhaxhai i vogel Hamdiu i cili, siç thoshin ata qe e kane njohur, i ngjan te atit (gjyshit tim) per nga bujaria, çiltersia dhe zemërgjerësia. Dhe ne do ta kemi ate, këshillues te përhershëm.

## Shkëlqesi, pi një gotë për shpirt të babait!

(vijon nga faqja 7)

Nga leximi i shenjave në pëllëmbë të dorës time ajo më tha se ndodhesha në një udhëkryq për jetën time. Më tregoi se në pëllëmbë të dorës ndodheshin dy rrugë dhe nëqoftëse do vazhdoja këtë udhëtimin e ri jeta do të merrte një rrjedhë të re!

"Nëqoftëse juve do vazhdoni këtë udhëtim që kini të para shkruar nga fati në jetën tuaj, do përballeni me shumë trazira dhe se në moshën 60-vjeçare, juve do t'ju ndodhë një e "keqe e madhe"! Kur unë degjova se kjo e keqe do më ndodhë në atë moshë, vendosa të vazhdoj udhëtimin tim për t'kthyer në atdhe. Me mendimin atëherë, se unë le të jetoj 60 vjet pa nuk dua të jetoj më gjatë. Për çudi koha bëri të sajën, vitet rrodhën, ai babai thoshte shpesh: "Çfarë më ka thënë ajo fallxhorja për këto 40 vjet që kanë kaluar, më kanë dalë të gjitha një për një, tashi ngelet për të parë e marrë vesh të keqen që do më ndodhë kur të mbush moshën 60 vjet!" Ai thoshte se kaq e kish të shkruar, aq do t; jetonte. Çuditërisht, kur mbushi moshën plot 60 vjet, në korrik të vitin 1976 ai u arrestua dhe u dënua me 8 vjet burg politik, sipas nenit famë keq, 55, për agitacion e propagandë, dënim që e kreu deri në nëntor të vitit 1982.

Ishte ky dënim që vërtetoi atë "profeci" të atij falli të shtënë në rininë time! Dhe më pas babai thoshte: "Nëqoftëse unë kam vuajtur në jetë edhe po të vuaj më, unë besoj dhe mendoj se më ka zënë ai "gjymah i madh" që kam bërë duke mos ju përgjigjur asaj "dashurie të madhe" me tërë shpirt të asaj grekeje të bukur, të zgjuar e shumë të pasur. Por besoj se kjo ishte e thëna, sepse në ato vite të luftës më duhej të isha shtylla e shtëpisë, mbasi katër vëllezër ishin në mal partizanë Loni, Dhosi, Rakua, Pirua dhe dy të tjerë ishin fëmijë të mitur shto dhe dy prindërit të vjetër në moshë, Për ato përballje me ato vështirësi e sakrificat të atyre edhe gjatë atyre viteve u "shpërblye" më vonë, nga

viti 1959 e në vazhdim nga një luftë klase të pa parë! Duke u nënshkruar me heqje nga puna e deri në burgosje politike, të gjitha këto me pasoja të rënda sa morale, ekonomike e politike, për mua e gjithë familjen e për fatin e fëmijëve të mi. Por kjo ishte e thëna, kështu ishte i përcaktuar fati i atij njeriu i cili duhet të jetonte disi gjatë. Mbese në nderim e të "Asaja" e në kujtim të asaj kohe e atyre viteve, atij ju dha rasti e shkoj në Selanik si turist tek e bija e dhëndëri i tij, Th. Lera, në vitin 2000 dhe qëndroj atje dy muaj, gjatë qëndrimit të tija atje tek e bija. Veronikës i vinin për vizite e për të pirë kafe e për ta njohur e respektuar të atin e saj, zonja të vjetra greçka që kishte ajo gjitone, të cilat mbasi u njohën e biseduan disa herë me atë burrë, ngelën shumë të kënaqura, edhe nga pamja e tij fisnike me ata flokët e tija të bardha me onde edhe tashmë në moshën 80-vjeçare, për komunikimin e tij në greqisht lehtësisht me ato e për dituritë e tija në shumë fusha si njohjen e historisë nga koha e antikitetit, ato zonjat e vjetra të nderuara greçka që më parë ju kish folur e bija për historinë e atij vitit të largët 1941. Më pas ato zonjat e nderuara, të vjetra e të reja i thoshin asaja: "Veronika, nuk paska gabuar, ajo mikja "jonë greke para 60 vjetësh!" E paskeni babain zotëni "qirje burrë!" Dhe nuk resh-tën ato Zonja ta vizitonin çdo mëngjes duke e përshëndetur "Kalimera qirja Anastas" dhe i çonin dhurata të ndryshme, Pako me kafe, Pije konjak metaksa, uzo, paketa cigare etj. Dhe ndjeheshin shumë të kënaqura për pirjen e kafesë së mëngjesit në shoqërinë e atij burri të vjetër tashmë më i fisnikërua e nga thinjat e moshës mbi të tetëdhjetat e tija!

**Shënim:** Ky shkrim është marr nga monografia jeta e Anastas Ligor Pihonit i njohur nga bashkë qytetarët Tashku i Golës i Lindur në Pogradec më 1917 vdekur më 2004 E shkruar në shtator të vitit 2009 "Shkëlqesi", pi një gotë për shpirt të babait!"

## LLËNGA NË RRJEDHËN E HISTORISË

Nga Mina PAÇO

Llënga, është e njohur në histori, si një qendër me mbi 12000 banorë, me aktivitete të ndryshme tregëtare, bujqësore, e blegtorale. Ka qënë qendra e kishës për zonën e Mokrës, dhe më gjërë, por ajo në rrjedhën e historisë është zvogëluar shumë, por po mbijeton si emër. Pas viteve 1990 nga Llënga kanë migruar dhe emigruar shumë banorë, për shkak të infrastrukturës jo të mirë. Por banorët e saj nuk e harrojnë Llëngën, ata vijnë për çdo 28 korrik në festën e Shën Marenës, vijnë në verë dhe pushojnë, Llënga nuk largohet nga zemra e tyre .

Unë që po ju shkruaj jam një banor nga Llënga dhe jam larguar që nga viti 1965, dhe banjo në Tiranë por, në Llëngë shkoj për çdo kohë vere.

Në vitin 2010 në Llëngë, banon Andon Kokoneshi, Nasi Tona, Jorgji Tamila, Ben Verushi, Avram Verushi dhe një familje

je nga fisi Gjoka, pra 7 familje. Ndërsa zoti Dhimitraq Zhabro, shkon pushon në verë, dhe largohet në dimër në Pogradec.

Banorët e Llëngës, mbijetojnë me anë të blegtorisë dhe me disa aktivitete të vogla tregëtie, Kopi merret me Shën Marenës, Jorgji Tamila e ka shtëpinë në krye të fshatit, me prejardhje nga Divjaka, dhe merret me blegtori.

Djemtë e motrës Andoria, jetojnë e punojnë në Llëngë, Llazi ka një lokal tregëtie, Kopi merret me Shën Marenën dhe Anastasi është shofer, dhe me makinën e tij bën rrugën Llëngë-Pogradec e kthim. Ata janë shumë të dashur, të mikpritur dhe bujarë dhe po bëjnë përpjekje për ti zgjatur jetën Llëngës sonë.

Ne ish banorët e Llëngës të shkojmë herë pa shere, të mos e harrojmë vendlindjen tonë. Pushteti Vendor të mos harrojë Llëngën, edhe me kushte të këqia të rrugës, ajo ka nevojë për ju, edhe do t' u shpërblejë me turistët që do të vijnë.

Kryeredaktor; Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"

Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës

Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

[www.poradeci.com/mokra](http://www.poradeci.com/mokra)

## Një projekt që kërkon mbështetje

Nga Maliq TORRA

Janë të shumtë ata jomokrarë, që e njohin dhe e vlerësojnë Mokrën për vlerat e gjithanshme që ajo ka, si ato vlera shpirtërore të fisnikërisë mokrare, por edhe vlera të etnografisë, vlera muzikore, zakonore e metej. Më mirë se kushdo tjetër këto thesare të vyera, të papërsëritshme të kësaj krahine, i njeh dhe profesori, studiuesi i nderuar z. Zenel Lamçe.

Ai ka punuar për një kohë të gjatë fshatrave të Mokrës. I njeh banorët jo vetëm si emër por ajo që ka vlerë e rëndësi për t'u theksuar, njeh shumë mirë botën e tyre të brendshme, shpirtin e tyre bujar, seriozitetin mistik e humorin e hollë dhe fin të mokrareve. Në bisedë e sipër me këtë personalitet të spikatur e studiues pasionant, zbuluam një dëshirë dhe njëherësh

një brengë të cilën e mbarthe prej vitesh. "Kam kohë që mendoj për një ide, madje kam përgatitur dhe një platformë për një reportazh televiziv ku te evidentohen të gjitha vlerat shpirtërore, kulturore, muzikore, zakonore, etnografike të Mokrës". Më tej vazhdoi bisedën me një entuziazëm e frymëzim për t'u admiruar, duke folur për ashefin, çerepin, saçin e poçen e fasules që zien në prushin e oxhakut mokrar ... me shumë pasion e dashuri të flet për nardenin dhe pekmez, për sëndukun e nënave mokrare që bie erë molle e aromë ftoi. E ku përmenden tërë ato vlera që profesori i njeh me themel dhe në mokraret po i humbim, po i harrojmë dalëngadalë. Realizimi i këtij dokumentari - reportazh është i domosdoshëm. Ideja dhe projekti ekzistojnë, dëshira dhe aftësitë intelektuale janë. Ajo ç'ka mungon është mbështetja fi-

nanciare. Pyetja që i bëjmë vetes ne mokraret është "A nuk jemi ne në gjendje për ta mbështetur këtë ide financiarisht?" Gjithësecili nga ne do ta jepte kontributin e vet, me aq sa të kishte mundësi. Ky investim i vogël sot do të ishte me vlera të pakrahueshme nesër. Do t'u lemë brezave që do të vijnë (pse edhe jo të sotmeve që i kanë humbur) një pasuri, një identitet e një traditë të pasur. Është një thirrje që u bëhet të gjithë mokrareve kudo që ndodhen, pushtetarëve lokalë, bizneseve, intelektualëve e emigrantëve. Mokra dhe vlerat e saj, nëse nuk evidentohen dhe ruhen janë në rrezik për të humbur. Nëse doni që ato të ruhen e të vijnë të gjalla, ashtu si ato janë e kanë qenë, jepe edhe ti ndihmën tënde sado e vogël qoftë, për t'u bërë dhe t'i pjesë e këtij kontributi të përbashkët.



Një rrugëtim në botën poetike të poetit pogradecar

## E VËRTETA NJERËZORE NË POEZINË E DHIMITËR POJANAKUT

Botimet poetike, "Shiu lexon trishtimin tim" 1991, "Mëngjes dhe pak natë" 1993, "Xhindet kërcejnë polka" 1999, "Gurët zbardhin natën", 2002. "Shtëpia ime rrotullon qiellin":

ÇMIME, 1996-çmim ndërkombëtar për poezinë në Milano, 1997-çmim ndërkombëtar për poezinë në Francë, 2002-çmim special në Itali. 2003-çmim ndërkombëtar në takim poetic me poetë nga Shqipëria, Greqia, Maqedonia. 2003-"Penda e argjentë" për vëllimin "Gurët zbardhin natën". 2005 merr titullin "Qytetar Nderi" i pogradecit. 2006-Çmim në takimin poetic ndërkombëtar në Shkup, Maqedoni. 2007-Çmim në "Ditët e verës", në Elbasan. 2008-Çmimi "Lasgush Poradeci" në takimin e vjeshtës, Korçë.

Poezia e Pojanakut është natyrë e gjallë që mëshiron një qiell që shkoqit terrin verbues ndaj çdo trupi të humbur. Ai nuk mund të të shpëtojë nga e keqja, nga misteri, por mund të përshkruaj të keqen se si luan me fatin e njeriut të shkretët. Parrulla e recitimit të tij, dhe e keqja nuk përsëriten më! Këtu ka lindur dhe një pjesë e ironisë së tij ndaj vetëvetes, turmës, qiellit. Prandaj, dhe e bukura kërkon nevojë shpirtërore të lindur, e cila dëshmon se nuk është bosh, andaj ka lindur nga nevoja. Poezia e tij është tepër njerëzore, pavarësisht ironisë therse, tekave, naivitetit, këto të fundit kanë lindur tek shpirti i tij si pasojë e fatit të hidhur shoqëror, por megjithatë, në thelb poezia e tij përmban meditim kontemplativ mbi të

drejtën e shoqërisë njerëzore, mbi të vërtetën humane njerëzore, mbi qiellin mistik, mbi shpirtin krijues. Është si verë e kuqe, që noton drejt gjakut të tij, si anija pa vela. Gati e vetmuar. Edhe shpirti i tij është i vetëmuar, por jo dhe poezia e tij. Poezia e poetit Pojanaku është një gur i çmuar i fshehur në brendësinë e tij si të jetë me vakum, duke rrezatuar natën, ndirtjen e arsyes fjalës. Poezi e thellë, bindëse, kurajoze, e ngjashme me vetveten. Pojanaku është poet i asaj gjenerate që arrin të imponohet pranë lexuesit me një poezi të kulluar, të pas-truar me vakum, duke rrezatuar natën, ndirtjen e arsyes fjalës. Poezi e thellë, bindëse, kurajoze, e ngjashme me vetveten. Pojanaku është poet i asaj gjenerate që arrin të imponohet pranë lexuesit me një poezi të kulluar, të pas-truar me vakum, duke rrezatuar natën, ndirtjen e arsyes fjalës. Poezi e thellë, bindëse, kurajoze, e ngjashme me vetveten. Pojanaku është poet i asaj gjenerate që arrin të imponohet pranë lexuesit me një poezi të kulluar, të pas-truar me vakum, duke rrezatuar natën, ndirtjen e arsyes fjalës.

Me anë të fjalës emocionale, poeti dëshmon kundrejt humbjes, trishtimit shpirtëror, çhumanizmit njerzor, mbase kjo është një veti e tij e mirë që shquan botën e shpërfillur nëpërmjet të drejtës natyrore, që është arsyeja ndaj së vërtetës njerzore. Poezia e tij është një grusht i fuqishëm ndaj revoltës, ndaj turmës dhe ndaj trishtimit të verbër të shpirtërave të lirë, dhe nëpërmjet fjalës, tekave të tij hënore ai mund çdo lakuriqësi mendimesh që mundohen të zhveshin autencitetin njerzor. Një trakt intelektit prej poeti filozof mund të vihet përballë çdo të metë që e ndikon botën dhe ligjet e saj fizike.

Bujar PLOSHTANI

## SHËRBESA FETARE NË MOKËR

Në krahinën e Mokrës mbi 90 përqind popullsië është me besimin mysliman, dhe 10 përqind me besim krishter (fshati Podgozhan, Pelevan dhe një lagje në Pleshisht).

Për besimin krishter është ndërtuar këto vite një kishë e re në Llëngë, dhe një tlybe është ndërtuar në një kodër në Pleshisht. Për besimin mysliman, në Vërri është ndërtuar një xhami e re, ku kryehen ritet fetare me hoxhë Flamur Feron. Në fshatin Senisht është një xhami e vogël, ku bën ritet fetare hoxhë Fadil Isufi.

## TAKIMI ME MËSUESIN E PARË, SELMAN LEKA

Nga Zenun FERRO

Takimi me mësuesin e parë në çdo kohë është takimi i parë. Edhe në takimin e 20 gushtit 2010 ai ishte si takimi i parë, në klasën e parë në vitin 1961.

Ishte në shtëpi në fshatin Slabinjë, me bashkëshorten Selvije nga fshati Jollë, një grua fisnike. Djemtë në mërgim, ata të dy punojnë në shtëpi, edhe pse janë në pension. E gjeta duke zier rakinë e manit për të dytën herë. Kishte nxjerrë një

raki shumë të mirë.

Takimi ishte i ngrohtë, si mësuesi me nxënësin, me mësuesin e parë. Nga goja e tij e "heshtur, dalin disa kujtime. Kam punuar mësues shumë në fshatin e lindjes Slabinjë, në fund e mbylla në Losnik.

Më lodhi fundi, shkoja e vija në Losnik në këmbë, isha korrekt me orarin e mësimit, dhe nisesha herët, rruga për të shkruar mbi dy orë.

Nuk i'u luta njeriu, të më sillnin në fshatin e banimit në

Slabinjë. Drejtuesit e dinin, por nuk donin, ishin drejtues jashtë fshatit, dhe drejtonin për interesat e tyre.

Mosha bën të vetën, mësuesi i parë tregon me dashuri. Brezi i ri po rritet, por nuk e ka atë dashurinë për të vjetrit si duhet. Ai ka problemet e veta. Shikon që çdo gjë t'i vijë nga jashtë, nuk ulet të punojë, në pronat e veta, por shkon në Greqi, e Itali dhe punon. Prona të mban gjallë jetën, ajo mban njeriun. Punë, e jo pa punë.

## Homazh për nënë Sherife Balliun

Më 29 tetor 2010 u nda nga jeta Sherife Balliu. Ajo lindi në Slabinjë, më 23 maj të vitit 1922. U martua në vjeshtën e vitit 1939 me Hamit Balliun me të cilin jetoi 71 vjet. Bijë e familjes së ndershme e punëtore të Sali Sinanit, diti të jetë bashkëshorte e shkëlqyer, nënë e mrekullueshme, grua me dinjitet, njeri i vërtetë me të gjitha virtytet. Rriti dhe edukoi me përkushtim e dashuri 7 fëmijë, 5 djem 2 vajza. Qe krahu i djathtë i të shoqit në gëzime e halle, në shqetësime e vuajtje, qe

zemër e dhembshur për fëmijët, nipërit, stërnipërit, mbesat e stërmbsat, qe shtylla e familjes. Kudo ku ajo punoi, tregoi me mirësjellje e fisnikëri cilësitë më të mira. E krijoi respektin me punën që e bënte si dinte vetëm ajo, me fjalën e ëmbël që e kishte ilaç e shkruar ilaçit, me mikëpritjen në çdo orë të ditës e të natës, kur vinin miq të shumtë të familjes, bashkëshortit e fëmijëve.

E përcollëm me dhimbje këtë grua kurajoze e të mrekullueshme. E përcollëm me krenari se iku nga kjo botë pa bren-



ga. Ka lënë njerëzit e saj më të dashur ashtu si i donte ajo me shëndet e me dëshira të plotësuar.

Agim GORICA

## Xhemile Kajo Face, nëna që do t'u mungojë të gjithëve

Më 29 gusht 2010, pas një sëmundjeje të rëndë u nda nga jeta Xheile Kajo Face. Ajo do të kujtohet si një grua trimë, punëtore, nikoqire dhe një mikpritëse e mirë dhe mbartëse e traditave mokrare, të cilat ua futi në gjak edhe fëmijëve të saj.

Xhemile Kajo Face u lind në fshatin Lin të rrethit Pogradec, më 2 shkurt 1931, në një familje me tradita atdhetare. Qysh në moshë të re familja e saj ndjeu



mjerimin e rëndë që kishte pllakosur fshatin dhe gjithë Shqipërinë. Nënë Xhemilja vinte nga një familje e fisit të Bashallajve nga Lini. Vëllai i saj, Muredin Bashallaj, që në ditët e para të lëvizjes mori pjesë në Luftë. Ai ra dëshmor për të mos u harruar kurrë në Kërrabë të Tiranës. Në janar 1951 Xhemilja martohet me z. Selim Face, mësues nga fshati Urakë, një familje e nderuar dhe e respektuar.

Edhe kjo familje, gjatë Luftës, i pati dyert e hapura për trimat që ranë për liri. Nga martesat Nënë Xhemilja lindi tetë fëmijë të mrekullueshëm: Xheneten, Arifin, Rexhepin, Ganiun, Diturin, Xhevdetin, Sadeten dhe Lumuturiun, të cilët, së bashku me Selimin nënë Xhemilja i rriti më së mirë, edhe pse në kushte të vështira ekonomike. Ditën punonte në kooperativë, natën merrej me edukimin, pastrimin, ushqimin e fëmijëve për t'i përgatitur ata për shkollë. Ajo ishte një nënë me zemër ët madhe, mendohej që edhe bashkëshortit të saj t'i linte më shumë kohë për t'u përgatitur për mësim. Po-

rosiste gjithmonë edhe fëmijët që Selimit, babait të tyre të mos i sillnin shqetësime nga problemet e ndryshme që kishte jeta. Edhe në punë Nënë Xhemilja ishte mjaft e rregullt dhe i kreu më së miri detyrat e saj.

Me vdekjen e saj bashkëshorti, fëmijët, nipërit e mbesat humbën njeriun më të dashur të zemrës, të cilët e përcollën me nderim e respekt për në banesën e fundit. Gazeta "Mokra" merr pjesë në hidhërimin e familjes dhe të afërmeve të saj dhe i ngushëllon ata për largimin e njeriut të tyre të dashur!

Sami LEKA